

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5459  
E martë, 24 prill 2018  
çmimi 0.40 €

## Platforma e Veselit për unitet politik përfshinë pesë tema

Dialogu me Serbinë, themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, themelimi i Ushtrisë së Kosovës, agjenda e integrimi evropiane dhe reforma zgjedhore janë pesë temat me interes kombëtar për të cilat kryeparlamentari Kadri Veseli po kërkon bashkimin e spektrit politik në vend ■ FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

**PRESIDENTI THAÇI NË HOLANDË: KOSOVA ËSHTË NJË RRËFIM SUKSESI** F. 2

**QEVERIA KËRKON MOBILIZIM PËR AVANCIMIN E AGJENDËS EVROPIANE** F. 3

**TË PAGJETURIT, TEMA MË E DHIMBSHME QË KA VENDI** F. 6

### EKONOMI

**TERMOCENTRALI "KOSOVA E RE", BAZAMENTI I ZHVILLIMIT EKONOMIK TË KOSOVËS** F. 10



Valdrin LLUKA

**SHËRBIMET E "KUJTESËS" TANI PAGUHEN EDHE NË SPORTELET E POSTËS** F. 8

### KULTURË

**INSTITUCIONET TË BËJNË MË SHUMË PËR TA PËRKRAHUR LIBRIN** F. 13

**ELENA HALILAJ PËRFAQËSON KOSOVËN NË MALTË** F. 13

### SPORT

**BERISHA: FUSHA, PENGESË E MADHE PËR FC DARDANËT** F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE" POLITOLOGU RAMUSH TAHIRI  
■ FAQE 4-5

## Iniciativat për konsensus kombëtar nuk do të kenë sukses

Politologu Ramush Tahiri nuk beson në suksesin e iniciativave të subjekteve politike për arritjen e konsensusit kombëtar rreth çështjeve të mëdha. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se iniciativa e Partisë Demokratike të


Kosovës (PDK) dhe ajo e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë të pasinqerta dhe do të dështojnë. Sipas tij, subjektet politike nuk do t'u përgjigjen pozitivisht këtyre iniciativave, duke i vënë kushte njëra-tjetër. Tahiri ka bërë me dije

se iniciativat e tilla janë të shtyra nga pat pozicioni që gjenden pozita dhe opozita. Ai ka deklaruar se opozita nuk i ka 61 vota për ta rrëzuar Qeverinë, kurse kjo e fundit nuk e ka shumicën e nevojshme për t'i shtyrë proceset përpara

## Telekomi, në krizë të thellë financiare

Kryesuesja e Bordit të Telekomit të Kosovës, Besa Shatri-Berisha, ka bërë me dije të hënën se kjo ndërmarrje publike është duke u përballur me humbje të mëdha financiare. Në raportimin e saj para kabinetit qeveritar, Shatri-Berisha ka thënë se vetëm në tremujorin e parë të këtij viti kjo

ndërmarrje ka pësuar humbje prej 4 milionë eurosh. "Telekomi gjendet në krizë të thellë financiare", ka thënë ajo, duke treguar se gjendjen financiare e rëndojnë numri i madh i punëtorëve, borxhi mbi 60 milionë euro, kalimi në kodin 383 dhe mirëmbajtja e rrjetit të vjetruar ■ FAQE 9



## Anëtarësimi në OKB, njohjet dhe integrimi evropian, prioritetet kryesore

Njohjet dypalëshe, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, me theks të veçantë në OKB, si dhe integrimi evropian mbeten prioritetet kryesore të Kosovës. Kështu është thënë të hënën në tryezën "Politika e jashtme e Kosovës: prioritetet dhe sfidat" që

është organizuar nga Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS). Sipas të pranishmëve në këtë tryezë, sfida për Kosovën janë beteja diplomatike, dialogu me Serbinë, koordinimi ndërinstitucional dhe bashkëpunimi rajonal ■ FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat.styro@yukon.com](mailto:sat.styro@yukon.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Tusk sot në Tiranë

Tiranë, 23 prill - Pas reko- mandimit për çeljen e negoci- atave për Shqipërinë gjatë javës së kaluar, presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, vjen sot (e martë) në

Tiranë. Vizita e tij vjen në kuadër të një turi më Ballkanin Perëndimor, i cili nis sot (e martë) në Tiranë.

Në vijim ai do t'i vizitojë Malin e Zi, Maqedoninë, Serbinë dhe

Bosnjën.

Por mësohet se vetëm një ditë më vonë, gjatë së mërkurës, kryeministri Edi Rama do të udhëtojë drejt Gjermanisë.

Gjatë së enjtes ai pritet të zhvil-

lojë një takim me kancelaren gjermane Angela Merkel, në kuadër të lobimeve për vendet skeptike të Bashkimit Evropian, për hapjen e negociatave me Shqipërinë.



# Presidenti Thaçi në Holandë: Kosova është një rrëfim sukcesi

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Kosova është një rrëfim sukcesi, por ka ende sfida të shumta, ashtu siç kanë të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Por, prej shumë sfida-ve që ka Kosova, ai ka numëruar tri si më të rëndësishmet, e që kryesorja, sipas tij, është përmbyllja e dialogut me Serbinë

HAGË, 23 PRILL - Me ftesë të Institutit holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare "Clingendael", presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, para shumë përfaqësuesve shtetërorë, diplomatëve, gazetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, ka mbajtur një ligjëratë me temën "Vizioni, sfidat dhe mundësitë për Kosovën". Ai ka thënë se paqja dhe drejtësia janë dy çështje themelore për çdo shoqëri, veçanërisht për ato në tranzicion. Ai ka shtuar tutje se Haga është një vend ku pavarësia e Kosovës u konfirmua e ligjshme nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. "Pas këtij Opinioni Këshillëdhënës më 2010, filloi dialogu politik në mes të Kosovës dhe Serbisë. Dialogu prodhoi një marrëveshje historike në Bruksel, saktësisht pesë vjet më parë. Kjo ndodhi pas më shumë se njëqind vjet konflikti", ka shtuar ai.

Presidenti Thaçi në Hagë ka theksuar se është natyrisht edhe vendi ku një pjesë e sistemit të drejtësisë në Kosovë tani është e vendosur, duke dëshmuar

gatishmërinë e Kosovës për të bashkëpunuar me drejtësinë ndërkombëtare gjithmonë. "Ne jemi krenarë me luftën tonë për liri dhe nuk kemi asgjë për të fshehur apo për t'u frikësuar nga e vërteta. Askush asnjëherë nuk u përpoq të ikte apo të fshihej nga drejtësia, krahasuar me shtetet e tjera në rajon", ka shtuar ai.

Duke folur për shtetndërtimin në Kosovë, presidenti Thaçi ka thënë se vetëm dhjetë vjet më parë Kosova shpalli Republikën më të re në Evropë dhe tani mund t'i shikojmë me krenari arritjet gjatë dekadës që shkoi.

Duke pasur parasysh pozicionin tonë fillestar, sipas tij, ka qenë një sfidë e madhe dhe natyrisht se gjatë këtij udhëtimit kemi pasur sfida dhe sukse. Para shumë të pranishëmve, presidenti Thaçi ka thënë se rritja e parashikuar ekonomike për vitin 2018 është gati 5 për qind, siç parashihet edhe për vitin 2019, derisa Kosova ka nënshkruar investime të reja mbi 1 miliard euro vitin e kaluar, veçanërisht në sektorin e energjisë. Sipas tij, Kosova është një rrëfim sukcesi,



por Kosova ka ende sfida të shumta, ashtu siç kanë edhe të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Presidenti Thaçi ka numëruar tri sfidat më të rëndësishme, ku së pari është përmbyllja e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se Kosova është e hapur për të gjetur zgjidhje. "Si Kosova ashtu edhe Serbia duan të jenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe të dy shtetet e dimë se duhet ta njohim njëri-tjetrin. BE-ja nuk do të na pranojë me probleme. Ne kemi nevojë për një marrëveshje ligjërisht të detyrueshme. E di se do të jetë jashtëzakonisht e

vështirë për të dyja palët, mbi të gjitha për Kosovën. Por, jam i bindur se dialogu dhe marrëveshja janë e vetmja rrugë përpara", ka shtuar ai.

Sfida e dytë për Kosovën, sipas tij, është ekonomia. Ai ka thënë se Kosova po vazhdon të shënojë rritje, por ka nevojë për të krijuar më shumë vende pune. "Ne duhet të përqendrohemi në ekonominë e re dhe në mundësitë e reja. Nuk është e lehtë dhe ne ende duhet të bëjmë më shumë reforma strukturore", ka shtuar ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se sfida e tretë ka të bëjë me integrimin e

Kosovës në NATO dhe BE ku, sipas tij, Kosova po punon për përbushjen e kriterëve demokratike në politikë, ekonomi dhe legjislacion.

Presidenti Thaçi, pas ligjëratës, ka bashkëbiseduar me përfaqësues të shtetit holandez, diplomatë, ambasadorë, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ai ka marrë pjesë edhe në prezantimin e librit biografik "New State, Modern Statesman", të autorëve Roger Boyes dhe Suzy Jagger. Prezantimi i librit është bërë në Institutin holandez për Marrëdhënie Ndërkombëtare "Clingendael".

## Majlinda Bregu, sekretare e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal

Tiranë, 23 prill - Pozita e sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal do të ketë tashmë një kryetare femër dhe ajo është ish-ministrja e integritimit në qeverinë e PD-së, Majlinda Bregu. E vendosur në një garë përballë ish-kryeministrit dhe ministrit të Jashtëm malazias, Igor Lukshiq, Bregu ka arritur të triumfojë në zgjedhjet e mbajtura pak ditë më parë, duke marrë shumicën e votave.

Zyrtarizimi pritet të bëhet sot (e martë), por vetë ish-ministrja ka njoftuar këtë arritje nëpërmjet "Facebook"-ut. "Fituam! Unë fitova garën, por fitorja i takon vendit tim! Faleminderit të gjithëve që besuan dhe më votuan për pozitën e sekretarit të përgjithshëm të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. Mirënjohje të gjithëve, vendeve anëtare, institucioneve shqiptare, Komisionit Evropian,

EEAS (Shërbimi i Jashtëm i BE-së), Parlamentit Evropian, familjes sime politike EPP, mbi të gjitha vendeve që votuan bindshëm kandidaturën time. U përpoqën të gjithë, me qartësinë se drejtimi prej meje i këtij institucioni do të ishte fitore e Shqipërisë dhe shqiptarëve!", u shpreh Bregu.

"Jam e nderuar sot që për herë të parë më takon mua të drejtoj si e para shqiptare, në një pozicion të

lartë ekzekutiv, institucionin që ka si mision fuqizimin dhe rritjen e bashkëpunimit në vendet e Evropës Juglindore!", tha ish-ministrja e Integritimit. Ajo nuk ngurron ta falënderojë përzemërsisht për mbështetjen edhe një figurë të njohur të PS-së, siç është ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, pavarësisht se ai i përket spektrit tjetër politik. "Një falënderim miqësor për Ditmirin. Na ndajnë sinoret poli-



tike, por na bashkuan qasja evropiane dhe përpjekja për të punuar për Shqipërinë! E di se do të jetë një sfidë e vështirë, por nganjëherë e vështira është më e mira!", theksoi Bregu.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Qeveria kërkon mobilizim për avancimin e agjendës evropiane



Kabineti qeveritar ka miratuar planin aksional për adresimin e sfidave të Raportit të Progresit me anë të të cilit kërkohet mobilizim për avancimin e agjendës evropiane të Kosovës. Qeveria ka shprehur përkushtimin për t'i zbatuar reformat dhe obligimet e Kosovës në rrugën drejt aderimit në Bashkimin Evropian

**EPOKA  
ERE**

**Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 23 PRILL** - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së hënës ka miratuar planin aksional për adresimin e sfidave të Raportit të Progresit. Ky plan evidenton hapat që Qeveria e Kosovës do t'i ndërmarrë për t'i tejkaluar sfidat, duke bërë më të qartë dhe më të shpejtë rrugën e Kosovës drejt integritimit në Bashkimin Evropian (BE). "Në këtë kuadër, Qeveria është duke ndërmarrë reformat e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit, qeverisjen e mirë dhe zhvillimin ekonomik, që do të jenë me dobi për qytetarët tanë dhe që çojnë drejt marrëdhënieve edhe më të fuqishme me Bashkimin Evropian. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në vitin 2016, si një hap i rëndësishëm i arritur nga Kosova në procesin e integritimit evropian, jemi të

vendosur t'i zbatojmë këto reforma si dhe obligimet që i kemi marrë përsipër si shtet i pavarur në kuadër të marrëdhënieve kontraktuale me BE-në. Që nga fillimi i këtij mandati qeverisës kemi ndërmarrë hapa vendimtarë për zbatimin e reformave kyçe të identifikuar në Agjendën e Reformave Evropiane", thuhet në planin aksional për adresimin e sfidave të Raportit të Progresit.

Ndër të tjera, në këtë plan është thënë se Raporti i Progresit i publikuar nga Komisioni Evropian pasqyron arritjet që ka shënuar Kosova që nga raporti i fundit dhe vlerëson ato, njëkohësisht nënvizon ngecjet, mangësitë dhe problemet. "Raporti jep edhe rekomandime të cilat do të na ndihmojnë t'i shtyjmë përpara reformat e nënvizuara më lart dhe të ecim më shpejt në procesin e aderimit në BE. Prandaj duke u bazuar në këto rekomandime,

Qeveria e Kosovës përmes këtij plani ka identifikuar aktivitetet kryesore për adresimin e këtyre rekomandimeve. Gjatë hartimit të këtij plani janë marrë parasysh dokumentet kryesore planifikuese, duke përfshirë Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, Agjendën e Reformave Evropiane, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe dokumentet e tjera relevante. Plani përmban aktivitetet e qarta që duhen kryer, afatet kohore si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre aktiviteteve", është theksuar në plan.

Me këtë rast kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Qeveria është e përkushtuar që me përgjegjësi të plotë të përballë me sfidat e paraqitura në Raportin e Progresit. Sipas tij, Kosova do t'ia vërtetojë Bashkimin Evropian që është serioze dhe e fokusuar në procesin integruar. "Kemi miratuar

planin aksional për adresimin e sfidave të Raportit të Progresit, dokument i cili identifikon të gjitha mangësitë nga raporti i fundit i progresit dhe hapat që Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i ndërmarrë për t'i tejkaluar këto sfida drejt rrugëtimit tonë për në BE", është shprehur kryeministri.

Haradinaj ka pohuar se si Qeveri janë të përkushtuar të përballen me sfidat që atyre t'u japin përgjigje adekuatë si shoqëri dhe institucione shtetërore. "Kjo Qeveri do ta bëjë diferencën. Nuk do të humbim kohë, por do t'ua vërtetojmë partnerëve, në këtë rast Bashkimin Evropian, që Kosova është serioze dhe e fokusuar. Nuk jemi marrë vetëm me të arriturat, por edhe me sfidat, dhe kjo është me rëndësi shumë për Kosovën. Ne kemi nxjerrë listën e sfidave e që janë shumë. Raporti është krahasim në mes të gjendjes së sotme dhe të një anëtarit të BE-së. Ky vakum duhet të mbulohet. Nuk ka të bëjë me liberalizim. Ka të bëjë me një vend aspirues për të hyrë në BE. Ne duhet ta kalojmë rrugën deri atje", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Ndërsa ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, duke prezantuar përmbledhjen e rekomandimeve kryesore të Raportit të Progresit, ka thënë se iniciativa për miratimin e planit aksional është shumë e qëlluar. Ajo ka bërë me dije se në ditët në vijim Ministria e Integritimit Evropian do ta ftojë takimin e ardhshëm të Këshillit Ministror për Integritim Evropian si dhe do t'i diskutojë të gjeturat e raportit në kuadër të strukturave të brendshme për integritim evropian. "Një numër i madh rekomandimesh do të adresohet përmes zbatimit të Programit për MSA-në dhe Agjendës Evropiane të Reformave. Ministria e Integritimit do ta bëjë monitorimin dhe raportimin e rregullt për zbatimin e programit dhe ERA-s. Këtë vit edhe në kuadër të mbështetjes direkte buxhetore jemi zotuar se do ta arrijmë shkallën e zbatimit të programit prej 60 %. Si Ministri e Integritimit jemi të bindur që kjo do të arrihet, megjithatë do të sigurohemi të bëhet monitorimi i rregullt dhe në çdo rast do t'ju informoj për progresin dhe për zbatimin e programit", është shprehur Hoxha.

## Tahiri e Jashari pajtohen për bashkëpunim në fushën e drejtësisë




**PRISHTINË, 23 PRILL (ER)** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka vizituar të hënën Avokatin e Popullit, Hilmi Jashari, të cilin e ka njoftuar për agjendën legislative të kësaj ministrie, e cila, sipas tij, synon rritjen e kapaciteteve të sektorit të sundimit të ligjit, në veçanti fuqizimin e gjyqë-

sorit. Në këtë kontekst, ministri Tahiri ka theksuar rëndësinë që ka institucioni i Avokatit të Popullit për adresimin e shqetësimit të qytetarëve që kanë lidhur me punën e të gjitha institucioneve publike. Më tutje, Tahiri e Jashari janë pajtuar të bashkëpunojnë ngushtë, në

mënyrë që qytetarëve t'u ofrohet drejtësi më efikase. Ata kanë theksuar se bashkërendimi i veprimeve me aktorët e drejtësisë do të ndihmonte në adresimin më të shpejtë të problemeve, që përfundimisht do të mundësonte qasje më të lehtë në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Flet për "Epokën e re" politologu Ramush Tahiri

# Iniciativat për konsensus kombëtar nuk do



Politologu Ramush Tahiri nuk beson në suksesin e iniciativave të subjekteve politike për arritjen e konsensusit kombëtar rreth çështjeve të mëdha. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se iniciativa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ajo e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë të pasinqerta dhe do të dështojnë. Sipas tij, subjektet politike nuk do t'u përgjigjen pozitivisht këtyre iniciativave, duke i vënë kushte njëra-tjetrës. Tahiri ka bërë me dije se iniciativat e tilla janë të shtyra nga pat pozicioni që gjenden pozita dhe opozita. Ai ka deklaruar se opozita nuk i ka 61 vota për ta rrëzuar Qeverinë, kurse kjo e fundit nuk e ka shumicën e nevojshme për t'i shtyrë proceset përpara

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 PRILL -

"Epoka e re": Z. Tahiri, lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka propozuar një platformë politike për bashkimin e spektrit politik në pesë tema. Po ashtu, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka thirrur një tryezë të partive për ta kërkuar konsensusin kombëtar për temat që e

presin vendin. Si i keni parë këto iniciativat?

Tahiri: I ka shtyrë pat pozicioni i mbetur. Partitë opozitare nuk i kanë votat e mjaftueshme për ta rrëzuar Qeverinë, kurse Qeveria nuk i ka votat e mjaftueshme për t'i shtyrë programet e saj përpara. Asnjëra palë nuk mund t'i sigurojë 61 vota që janë të nevojshme në Kuvend. Gjithashtu, asnjë parti deri më tani nuk është deklaruar se dëshiron zgjedhje të parakohshme parlamentare. Si

duket tani për tani nuk do të ketë zgjedhje të reja parlamentare dhe në këtë drejtim të gjitha partitë po e shfrytëzojnë për një lloj animimi të opinionit të brendshëm dhe ndërkombëtar. Tani atyre po u duket argumenti më i mirë për t'u thirrur në konsensus kombëtar se duhet të ketë një marrëveshje të përgjithshme për çështjet madhore, dhe këtë po e bënë secila parti veçmas. Pas iniciativës për ta rrëzuar Qeverinë që nuk e çoi deri në fund, LDK-ja tash ka dalë me një propozim për ta realizuar një tryezë në të cilën do të diskutohet dhe do të arrihen parime për një konsensus kombëtar. Tash edhe Kadri Veseli në emër të PDK-së, gjithë liderëve të partive politike u ka dërguar një propozim për një platformë gjithëkombëtare, në të cilën i ka numëruar çështjet kryesore për të cilat duhet të arrihet konsensus. Ky konsensus po kërkohet në një tryezë të partive politike, që zakonisht atë duhet ta bëjë presidenti i Kosovës dhe kjo nuk po bëhet në parlament.

"Epoka e re": Sipas jush, cili është qëllimi i këtyre iniciativave?

Tahiri: Qëllimi i këtyre iniciativave

është për të blerë kohë dhe për të mos e humbur elektoratin. Pra, për ta mbajtur gjendjen e tensionuar në sensin pozitiv, duke thënë se kemi një agjendë dhe se jemi duke u munduar ta gjejmë një konsensus kombëtar për çështje të mëdha.

"Epoka e re": Pra, mendoni se partitë politike janë të detyruara nga rrethanat për të ndërmarrë iniciativat e tilla?

Tahiri: Mendoj se situata aktuale i ka shtyrë këto subjekte të ndërmarrin veprime të tilla. Me këtë dëshirojnë të tregojnë se nuk janë duke qëndruar kot, por po marrin iniciativat politike.

"Epoka e re": Besoni se do të kenë sukses këto iniciativat?

Tahiri: Këto iniciativat janë shumë të dëshirueshme dhe të nevojshme për faktin se Kosova ka humbur shumë kohë, dhe tani duhet për të ecur më shpejt se të gjitha vendet e tjera të rajonit për ta zënë hapin. Këto çështje nuk lidhen me programe veç e veç të subjekteve politike, por janë interes i të gjitha partive, para së gjithash, i popullit të Kosovës. Unë nuk pres rezultate, sepse synimet e asnjërit nuk janë të sinqerta.

Secila parti dëshiron të bëhet prijëse e iniciativave të tilla. Në këtë mënyrë besoj se këto iniciativat do të jenë të dështuara, sepse subjektet politike nuk do t'u përgjigjen pozitivisht këtyre iniciativave, por do t'i vënë kushte njëra-tjetrës.

"Epoka e re": Nëse nuk do të ketë konsensus nacional, si e shihmi zgjidhjen e këtyre çështjeve që për kërkohet konsensus?

Tahiri: Nëse nuk ka konsensus kombëtar për këto çështje, atëherë ato duhet të diskutohen dhe votohen në Kuvend, pasi është institucioni më i lartë ku merren vendimet e rëndësishme. Do të ishte më e ndershme që këto çështje të hapen në Kuvend, të diskutohen aty dhe të shohë opinionin se kush çfarë po diskuton. Këta mund të mbajnë një seancë të jashtëzakonshme për secilën prej këtyre pikave që po i propozon Kadri Veseli apo LDK-ja. Nëse konsiderojnë se kjo është ndonjë strategji e caktuar, këto çështje mund të diskutohen në Kuvend në ndonjë seancë të mbyllur dhe të shihet se cili është propozimi më i mirë. Konsensusi nuk bëhet pse

# të kenë sukses



dikush po thotë, por konsensusi arrihet pse një propozim është më i mirë, më gjithëpërfshirës apo më i zbatueshëm se të tjerët.

**"Epoka e re":** Në një seancë të jashtëzakonshme në Kuvend pritet të diskutohet platforma e Qeverisë për finalizimin e dialogut me Serbinë. Çfarë mendimi keni për këtë platformë?

**Tahiri:** Më herët, kur janë nisur bisedimet, kemi pasur një rezolutë të Kuvendit, e cila prej miratimit asnjëherë nuk është shqyrtuar. Pra, asnjëherë nuk kemi pasur një raport të mirëfilltë të atyre që diskutojnë në Bruksel para Kuvendit. Tani është propozuar një platformë nga Qeveria, e cila do ta marrë formën përfundimtare në Kuvend. Besoj se ajo do të plotësohet, sepse secila parti do t'i japë propozimet e veta në Kuvend. Platforma që është propozuar i ka dy nivele: nivelin teknik, të cilin e udhëheq Avni Arifi dhe nivelin politik, të cilin do ta udhëheqë presidenti Thaçi. Përmes kësaj platforme synohet të arrihet një marrëveshje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo

platformë është e mirë dhe e nevojshme. Një platformë e tillë do të ishte mirë t'i merrte qind për qind votat e deputetëve në Kuvend, duke përfshirë edhe votat e Listës Serbe.

**"Epoka e re":** Si njohës i rrethanave politike në vend, çfarë do të duhej të përmbante tjetër kjo platformë?

**Tahiri:** Mendoj se platforma që ka propozuar Qeveria është e mirë. Ajo vetëm duhet të plotësohet me ndonjë propozim të opozitës. Unë nuk dëshiroj që në Kuvend të diskutohet se këto bisedime a duhet t'i udhëheqë presidenti Thaçi apo nëse z. Thaçi është figurë unifikuese. Mendoj se këto bisedime duhet t'i udhëheqë presidenti i vendit pa marrë parasysh se kush është në atë pozitë. Pra, Kuvendi për këtë çështje duhet të diskutojë profesionalisht. Platforma i ka përfshirë të gjitha çështjet që duhet të bisedohen dhe i jep drejtim dialogut. Mendoj se platforma duhet të parashohë që një herë në muaj të bisedohet në Kuvend për rezultatin e dialogut, nëse brenda muajit ndodhin tre ose katër takime në Bruksel.

## Platforma e Veselit për unitet politik përfshinë pesë tema

Dialogu me Serbinë, themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, themelimi i Ushtrisë së Kosovës, agjenda e integriteteve evropiane dhe reforma zgjedhore, janë pesë temat me interes nacional për të cilat kryeparlamentari Kadri Veseli po kërkon bashkimin e spektrit politik në vend

**EPOKA E RE**

**Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 23 PRILL** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka propozuar një platformë politike për bashkimin e spektrit politik në Kosovë rreth pesë temave me interes nacional. Këtë platformë Veseli ua ka dërguar të gjithë liderëve të partive politike, nëpërmjet së cilës u bënë thirrje për krijimin e një ekipi të përbashkët të liderëve politikë me pjesëmarrje edhe të shoqërisë civile për këto pesë tema: 1. Dialogu me Serbinë, 2. Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, 3. Themelimi i Ushtrisë së Kosovës, 4. Agjenda e integriteteve evropiane, dhe 5. Reforma zgjedhore.

Veseli ka pohuar se kjo platformë ka për qëllim arritjen e konsensusit politik për disa prej çështjeve më të rëndësishme me të cilat Republika e Kosovës është përballur më herët dhe

është duke u përballur aktualisht. "Çështjet të cilat do të përfshijë kjo platformë janë ndër më të rëndësishmet për perspektivën e Kosovës dhe qytetarëve të saj. Këto çështje që një kohë të gjatë janë duke e penguar ecjen përpara të Republikës së Kosovës. Me qëllim që të kemi një zgjidhje efektive, në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës, është i nevojshëm ndërtimi i konsensusit politik në mes nesh. Ky konsensus, para së gjithash, duhet ta reflektojë interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka thënë ai.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se në funksion të këtij qëllimi është i domosdoshëm krijimi i një ekipi të përbashkët, i udhëhequr nga presidenti i Kosovës, në të cilin do të përfshihen rol i të gjithë liderëve politikë dhe institucionale të vendit, si dhe personalitetet e shoqërisë civile. "Një praktikë kjo shumë rezultative gjatë proceseve historike nëpër të cilat ka kaluar Kosova, që nga Rambujeja deri

në shpalljen e pavarësisë", ka shkruar Veseli në platformën e tij. Ai ka theksuar se koordinimi dhe politikat e përbashkëta për çështjet e mësipërme janë rruga më e sigurt për të ecur më shpejt në përmblylljen e proceseve të shtetndërtimit dhe në avancimin e agjendës strategjike të integritetit euroatlantik të vendit tonë. "Përmes konsensusit dhe agjendës së përbashkët shtetërore ne, përfundimisht, e kthejmë politikën tonë në funksionin e saj themelor, i cili është shërbimi ndaj interesave të qytetarëve dhe shtetit tonë të pavarur dhe sovran", ka deklaruar Veseli.

Ndërkaq kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, i ka ftuar kryetarët e partive politike për të mërkurën në një tryezë të përbashkët me qëllim të tejkallimit të gjendjes së krijuar në vend. Në letrën dërguar partive politike, Mustafa ka pohuar se gjendja e krijuar politike në vend mund të zgjidhet veç me zgjedhje të parakohshme.



## Delawie kërkon përkushtim më të madh për ngritjen e nivelit të sigurisë

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovës, Greg Delawie, ka vizituar të hënën Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku është pritur nga ministri i ri, Bejtush Gashi. Ambasadori Delawie e ka uruar ministrin Gashi për detyrën e ministrit të Punëve

të Brendshme. Ai ka vlerësuar se është shumë i nevojshëm një përkushtim më i madh për ruajtjen dhe ngritjen e nivelit të sigurisë në Kosovë.

Delawie e ka ofruar përkrahjen e ShBA-së për forcimin e mëtejshëm të institucioneve të sigurisë në Kosovë. Ndërsa ministri i Ministrisë së

Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, e ka falënderuar ambasadorin Delawie për përkrahjen që ka dhënë ShBA-ja për fuqizimin e agjencive të sigurisë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ka kërkuar që kjo përkrahje të vazhdojë edhe në të ardhmen.



## Të pagjeturit, tema më e dhimbshme që ka vendi

Kryeministri Ramush Haradinaj ka shprehur përkushtimin e Qeverisë, që çështjen e të pagjeturve ta trajtojë me prioritet të veçantë, në mënyrë që familjarët e 1 650 personave që ende figurojnë të zhdukur, të mësojnë për fatin e më të dashurve të tyre

**EPOKA  
ERE**

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 23 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i shoqëruar nga kabineti qeveritar, deputetë të Kuvendit të Kosovës, ambasadorë të akredituar në Kosovë dhe familjarë të të pagjeturve, bëri homazhe te përmendorja e dedikuar personave të zhdukur, në shënim të 'Javës për Personat e Pagjetur', e cila ka nisur të hënën nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës. Me këtë rast, kryemi-

nistri Haradinaj ka thënë se sot është një ditë që rëndon shumë dhe na sjellë vuajtje dhe në kujtesë dhimbje, por që duhet gjetur forcën për të ecur para. "Duhet të jemi bashkë që të dalim përballë kësaj teme, që është tema më e dhimbshme që e ka Kosova", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së tij, që këtë çështje ta trajtojë me prioritet të veçantë, në mënyrë që familjarët e 1 650 personave që ende figurojnë të



zhdukur, të mësojnë për fatin e më të dashurve të tyre.

Po ashtu, edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka bërë homazhe te përmendorja dedikuar personave të zhdukur, me rastin e fillimit të "Javës për Personat e Pagjetur". Me këtë rast, Veseli ka kërkuar nga Serbia që sa më shpejt t'i kthejë në Kosovë trupat e personave të zhdukur sepse ky veprim, sipas tij, do të ishte lehtësim edhe për popullin serb. Sipas Veselit, kjo situatë është e rëndë edhe për institucionet e Kosovës pasi nuk mund të japin informacione rreth këtyre trupave pasi Serbia i mban të bllokuara këto informacione. "Kërkojmë edhe një herë

në këtë përvjetor që sa më shpejt, për hir të humanizmit, por edhe të drejtës që të dimë për fatin e njerëzve të cilët i kemi të pagjetur, të ndalet kjo plagë për këta familjarë të cilët mjaft kanë vuajtur deri më tani", ka thënë Veseli.

Bajram Qerkini, kryetar i Këshillit Koordinues të Asociacioneve të Familjarëve të Personave të Pagjetur, ka thënë se Serbia e di se ku gjenden trupat e personave të pagjetur. "Ju duhet të kërkonit nga autoritetet ndërkombëtare që të bëjnë presion tek autoritetet serbe, që të kthehen trupat e pagjetur. Ata e dinë se ku gjendet secila pjesë e trupit. Të gjallë ose të vdekur le t'i kthejë në Kosovë", ka thënë Qerkini.

## Haradinaj nderon Kandiqin me "Hartën e Artë të Kosovës"

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka prituri të hënën në takim aktivisten për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe themeluesen e Fondit për të Drejtën Humanitare me seli në Beograd, Natasha Kandiq, të cilën e ka nderuar me "Hartën

e Artë të Kosovës". "Të veprosim në një mjedis të pasigurt dhe të mos i ndash viktimat e dhunës sipas përkatësisë, por të kërkojmë drejtësi për to, është jo vetëm humanizëm i pashoq, por edhe guxim qytetar e njerëzor. Natasha Kandiq me Fondin për të Drejtën

Humanitare ka publikuar të dhënat më të sakta deri më tani për të vrarët në luftën e Kosovës dhe në shenjë nderimi për kontributin e madh, sot ia dedikova 'Hartën e Artë të Kosovës', duke e falënderuar për gjithçka që ka bërë për ta ndriçuar të vërtetën", ka thënë Haradinaj pas takimit.



# Anëtarësimi në OKB, njohjet dhe integrimi evropian, prioritete

Njohjet dypalëshe, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, me theks të veçantë në OKB, si dhe integrimi evropian, mbeten prioritetet të Kosovës. Kështu është thënë të hënën në tryezën "Politika e jashtme e Kosovës: prioritetet dhe Sfidat" që është organizuar nga Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS). Sipas të pranishmëve në këtë tryezë, sfida për Kosovën janë beteja diplomatike, dialogu me Serbinë, koordinimi ndërinstytucional dhe bashkëpunimi rajonal

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 PRILL - Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS) të hënën ka mbajtur tryezën "Politika e jashtme e Kosovës: prioritetet dhe sfidat", ku të pranishmit kanë thënë se Kosova ka prioritet njohjet dypalëshe, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, me theks të veçantë në OKB si dhe integrimin evropian. Kurse sfiduese, sipas tyre, mbeten beteja diplomatike, dialogu me Serbinë, koordinimi ndërinstytucional dhe bashkëpunimi rajonal.

Me këtë rast zëvendëskryeminstri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, duke folur mbi mbarëvajtjen dhe dinamikën e procesit të njohjeve, ka thënë se Kosova brenda ekzistencës dhjetëvjeçare si shtet i pavarur dhe sovran ka bërë hapa të mëdhenj në këtë drejtim, duke rritur numrin e njohjeve në 117. Megjithatë, ai ka thënë se

sfidues është ndryshimi i rrethanave në politikën ndërkombëtare dhe ballafaqimi me një fushatë gjithnjë e më agresive nga ana e Serbisë. "Duhet të punohet me vendet që e kanë njohur Kosovën dhe të avancohen edhe më tej marrëdhëniet në mes dy vendeve dhe paralelisht me këtë të punohet edhe për sigurimin e njohjeve të reja", ka deklaruar Pacolli.

Ndërsa sa i përket fazës përfundimtare të dialogut me Serbinë dhe arritjes së një marrëveshje të detyrueshme ligjore, zëvendëskryeministri Pacolli ka thënë se ky proces duhet të mbështetet në tri elemente. "Të ketë një kornizë të qartë kohore, të jetë tematik dhe të përfundojë me njohje të ndërsjellë në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Plani Ahtisaari duhet të shihet si maksimumi i koncesioneve të bëra nga ana e Kosovës", është shprehur ai.

Ndërsa kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë



dhe Investime Strategjike, Vjosa Osmani, ka thënë se krizat e njëpasnjëshme të shkaktuara nga koalicioni qeverisës kanë dhënë mesazh të keq për Kosovën para partnerëve ndërkombëtarë dhe kanë dëmtuar procesin e konsolidimit dhe forcimit të shtetësisë së Kosovës. Ajo ka folur edhe për procesin e njohjeve, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si dhe për fazën e fundit të dialogut me Serbinë. "Sa i përket platformës së Qeverisë së Kosovës për dialog me Serbinë, është dokument i cili synon që të përgjegjësinë për këtë proces t'ia kalojë presidentit i cili nuk është dëshmuar si faktor uniteti por, përkundrazi, si faktor

përcarës në vend. Ai nuk ka mekanizma implementues për marrëveshjet që do të arrihen dhe Kuvendi nuk ka mekanizma mbikëqyrës efektivë për punën e presidentit. Natyrisht se platforma duhet t'i përcaktojë jo vetëm afatet kohore, por edhe temat që janë jetike për Kosovën në mënyrë që të ecet përpara në procesin e normalizimit, siç janë fati i të pagjeturve, reparacioni për dëmet e luftës të shkaktuara nga Serbia", ka deklaruar Osmani. Kurse ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka vlerësuar se dialogu me Serbinë është jetik për Kosovën. "Është shumë e rëndësishme të investohet

energji në dialogun me Serbinë. Mungesa e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë është pengesë për të dyja shtetet", ka deklaruar O'Connell. Diplomati britanik ka thënë se Kosova si çdo shtet tjetër ka mundësi të japë kontribut në botë. "Kosova ka nevojë për përkrahje nga jashtë dhe do ta ketë këtë përkrahje. Interesat e Kosovës varen pak edhe nga përkrahja botërore dhe kjo përkrahje varet nga kontributi i Kosovës. Sjellja e Kosovës është e rëndësishme që t'i bindë politikanët e rinj në botë që ta përkrahin Kosovën. Kosova duhet të jetë shtet normal dhe të ketë sundim të ligjit", ka theksuar O'Connell.

## Italia rikonfirmon përkrahjen për Kosovën



PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Italisë janë dhe do të mbeten në nivel të shkëlqyer. Italia është afër Kosovës edhe si ndjenjë edhe si gjeografi. Ky ishte konstatimi i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë pritjes që i bëri të hënën ministres së

Mbrojtjes të Italisë, Roberta Pinotti.

Haradinaj ka falënderuar ministren Pinotti për kontributin e Italisë dhënë Kosovës në të gjitha etapat e zhvillimit, me theks në periudhën e pasluftës, duke kërkuar praninë e tyre edhe më tutje përmes investimeve, pasi Kosova ofron ambient të përsh-

tatshëm për investimet e huaja. Me këtë rast Haradinaj ka thënë se marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve tona, Kosovës dhe Italisë, janë dhe do të vazhdojnë të thellohen në të gjithë fushat e interesit të përbashkët, duke theksuar se edhe vizita e ministres Pinotti, e dëshmon këtë.

Gjatë këtij takimi është biseduar edhe për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri dhe në këtë proces, kryeministri Haradinaj ka kërkuar mbështetjen e Italisë, pasi kjo do të kontribuonte në forcimin e paqes dhe të stabilitetit rajonal. Ndërsa ministrja e Mbrojtjes e Italisë, Roberta Pinotti, ka

vlerësuar angazhimin e kryeministrit Haradinaj, duke thënë se Italia do të jetë përkrahëse e proceseve në rrugën e integritimeve euroatlantike të Kosovës. "Italia ka qenë një nga vendet e para që e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe një nga misionet më të rëndësishme. Ky partneritet do të vazhdojë", është shprehur Pinotti.

# Termocentrali 'Kosova e Re', bazament i zhvillimit ekonomik të Kosovës



**Valdrin LLUKA**

Nënshkrimi i marrëveshjeve komerciale për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" është ngjarje historike për popullin e Kosovës, sepse energjia është kushti i pashmangshëm për të ardhmen prosperuese ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Arritja e kësaj marrëveshjeje është rezultat i punës shumëvjeçare të Qeverive të Kosovës, i shumë njerëzve, shumë ekspertëve, që në kushte të vështira arritën t'i sigurojnë vendit të ardhme të sigurt energjetike. Ky akt është i rëndësishëm në shumë nivele, por ato që kanë rëndësi të theksohen janë rritja e qëndrueshme ekonomike, vazhdimi dhe rikonfirmimi i partneritetit strategjik, dhe sigurimi i

prosperitetit për gjeneratat e ardhshme.

Si fillim, ndikimi do të ndihet qysh në fazën e ndërtimit të termocentralit, kur do të angazhohen mijëra punëtorë përmes punësimit direkt ose përmes kompanive që do të nënkontraktohen. Ndërsa, në vazhdim, qindra vende pune afatgjatë do të krijohen për të operuar me termocentralin. Bashkë me ContourGlobal do të menaxhojmë një fond për zhvillimin e komunitetit që do t'i investojë 10 milionë euro në komunat e ndikuara duke krijuar vende të reja pune, rrjedhimisht duke rritur mirëqenien.

Me gjenerimin e garantuar 500 MW ne do ta sigurojmë pothuajse gjysmën e nevojës vendore vetëm me këtë njësi. Pjesën tjetër do të vazhdojmë ta marrim nga TC Kosova B, i cili do të rehabilitohet për ta kontrolluar ndotjen në nivelet e lejuara mjedisore. Këto do të jenë edhe burimet e vetme të energjisë që mbështetet në linjitin e Kosovës në dekadat që vijnë sepse marrëveshja që kemi nënshkruar parashih mbylljen e TC Kosova A, njësitë

e të cilat operojnë duke tejkaluar normat e lejuara të ndotjes së ajrit. Por, kjo nuk do të jetë energjia e vetme që do të gjenerohet nga termocentrali i ri. Kjo njësi do të shumëfishojë kapacitetin për energji termike nga i cili do të përfitojnë të gjitha komunat fqinje, duke përfshirë Prishtinën.

Më lejoni të konfirmoj që nuk mund të ketë tregues më domethënës për pozicionimin e Kosovës si destinacion për investime sesa kjo marrëveshje për TC "Kosova e Re". Investimet e huaja direkte po shënojnë suksese të reja, të cilat përkthehen në ndikim pozitiv dhe nxisin krijimin e vendeve të reja të punës. Me këtë investim po dërgojmë sinjal të qartë në botë se jemi vend me potencial dhe shtet që ofron siguri për investime.

Orientimi i Kosovës kah integrimet euroatlantike është i gjatë dhe kërkues, por është një garanci që shteti është në rrugën e duhur për zhvillim të qëndrueshëm. Zotimet e institucioneve tona janë në harmoni me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian, të cilat, në projektin për TC

"Kosova e Re", do të zbatohen në përpikëri. Zbatimi i këtyre standardeve kërkon zhvillim ekonomik dhe konkretisht energji të mjaftueshme dhe të qëndrueshme si parakusht për zhvillim. Kosova është me fat që edhe njëherë po dëshmon se po arrin të sigurojë investitorë serioz global, konkretisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të zhvilluar asetet e saja strategjike shtetërore.

Jam i lumtur që po bëjmë histori duke krijuar asete që po ndërtojnë Kosovën e së ardhmes. Me të filluar operimin, termocentrali "Kosova e Re" pritet të ketë një jetëgjatësi prej 40 vjetësh. Ky planifikim afatgjatë do t'i mundësojë shoqërisë ta projektojë një të ardhme prosperuese për gjeneratat që vijnë. Kjo periudhë do të kontribuojë jo vetëm në qëndrueshmëri në furnizim, por edhe garanton pavarësi nga çmimet rajonale të energjisë nga të cilat Kosova nuk do të varet në të ardhmen. Gjatë këtyre dekadave Kosova do të ketë kohë të mjaftueshme të krijojë kapacitete të reja prodhuese të bazuara në

burime të energjisë së ripërtëritshme. Ky është orientimi i Qeverisë së Kosovës që është në harmoni të plotë me politikat zhvillimore të shteteve të Bashkimit Evropian. Andaj, pas një serie të artikujve që i kam publikuar në vazhdim për t'i sqaruar opinionit publik se çfarë të mirash do të na sjellë realizimi i Projektit për Termocentralin "Kosova e Re", më lejoni të shtoj se me kontratat e nënshkruara ne, si Qeveri e Republikës së Kosovës, kemi vultur investimin më të madh të realizuar ndonjëherë në Kosovë që kap vlerën e 1.3 miliard eurove. Por, ky është vetëm fillimi, sepse me këtë po vendosim themelet e një ekonomie më dinamike, e cila pritet të shumëfishojë investimin në të ardhmen e afërt. Ekonomia për të cilën ne jemi përcaktuar do të mbështesë zhvillimin e vet në energji të qëndrueshme, do të llogarisë në furnizim stabil me energji elektrike, e bazament shumë i fuqishëm për t'i arritur këto do të jetë Termocentrali "Kosova e Re".

**(Autori është ministër i Zhvillimit Ekonomik)**

## Shërbimet e 'Kujtesës' tani paguhen edhe në sportelet e Postës

**PRISHTINË, 23 PRILL (ER)** - Kryeshefi ekzekutiv i Postës së Kosovës, Sejdi Hoxha, ka nënshkruar marrëveshje me drejtorin e shitjes në kompaninë "Kujtesa", Artan Metaj. Nga dita e hënë të gjithë klientët e kompanisë "Kujtesa" mund t'i paguajnë në sportelet e Postës pa provizion faturat për shërbimin TV kabllor dhe internetit. "Edhe një lajm i mirë nga Posta e Kosovës. Nga sot të gjithë klientët e kompanisë 'Kujtesa' mund t'i paguajnë pa provizion faturat për shërbimin TV kabllor dhe internetit në sportelet e Postës në mbi 150 zyra tona postare", ka thënë Hoxha.

Ai ka treguar se për këtë bashkëpunim e ka falënderuar drejtorin e shitjes së kompanisë "Kujtesa", Artan Metaj. "Ne gjithnjë kemi pasur qëllim që në një sportel të vetëm të Postës të paguhen të gjitha faturat për shërbimet e qytetarëve të Kosovës. Në këtë drejtim kemi arritur sukses të madh", ka thënë Sejdi Hoxha, kryeshef ekzekutiv i Postës së Kosovës.



# Telekomi në krizë të thellë financiare



Kryesuesja e Bordit të Telekomit të Kosovës, Besa Shatri-Berisha, ka bërë me dije të hënën se kjo ndërmarrje publike është duke u përballur me humbje të mëdha financiare. Në raportimin e saj para kabinetit qeveritar, Shatri-Berisha ka thënë se vetëm në tremujorin e parë të këtij viti kjo ndërmarrje ka pësuar humbje prej katër milionë eurosh. "Telekomi gjendet në krizë të thellë financiare", ka thënë ajo, duke treguar se gjendjen financiare e rëndojnë numri i madh i punëtorëve, borxhi mbi 60 milionë euro, kalimi në kodin 383 dhe mirëmbajtja e rrjetit të vjetruar

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 PRILL - Përfaqësuesit e Bordit të Telekomit të Kosovës kanë prezantuar të hënën para kabinetit qeveritar një informatë për gjendjen në ndërmarrje në të cilën kanë identifikuar faktorët që kanë çuar në një gjendje të keqe të ndërmarrjes. Në raport janë përmbledhur pasqyrat financiare dhe

performanca e Telekomit të Kosovës dhe ka identifikuar trendin e rënies së të hyrave dhe rritjes së shpenzimeve që është duke shkuar në drejtim të falimentimit të ndërmarrjes. Informata eidenton edhe masat që menaxhmenti është duke marrë për ta përmirësuar gjendjen e kësaj ndërmarrje që përmbledhin në mundësitë e kreditimit, investimet e huaja dhe plasimin e produkteve të reja në treg.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar nga Bordi i kësaj ndërmarrje të dërgojë edhe raport zyrtar, në mënyrë që të ndërmerren sa më parë hapat për parandalimin e kësaj situatë.

Kryesuesja e Bordit të Telekomit të Kosovës, Besa Shatri-Berisha, ka treguar se në fillim të këtij muaji bordi ka filluar punën duke analizuar gjendjen në të cilën gjendet Telekomi. Sipas saj, ata kanë 60 milionë euro borxhe dhe se janë në gjendje t'i paguajnë vetëm 18 milionë prej tyre. Shatri-Berisha më tej ka thënë se gjendjen e rëndon edhe numri i madh i punëtorëve. "Telekomi aktualisht gjendet në një krizë të thellë financiare. Borxhet e njohura të kompanisë janë mbi 60 milionë euro, prej tyre 11 milionë janë vetëm furnitorë të rregullt, përderisa humbja për tre muajt e parë është mbi 4 milionë euro. Të hyrat vazhdojnë të bien, ndërsa shpenzimet janë në rritje. Pasuria neto e kompanisë aktualisht është 34 milionë euro, ndërsa likuiditeti i cili e rrezikon më së shumti kompaninë është 0.3 %, që nënkupton se 60

milionë euro borxhe që i kemi, jemi në gjendje t'i paguajmë vetëm 18 milionë. Nga koha e diskutimeve për privatizim investimet në infrastrukturë janë ndalur thuajse plotësisht, përderisa janë keqmenaxhuar në maksimum mjete financiare të kompanisë", ka thënë Shatri-Berisha, duke shtuar se një problem tjetër është edhe pamundësia për t'i inkasuar mjetet e depozituara në Bankën Kreditorë të Prishtinës, e cila është në likuidim në vlerë 11 milionë euro.

Ajo ka pohuar se problem kyç tjetër është edhe kalimi në kodin 383 pasi, sipas saj, mungojnë mjetet për këtë gjë. Po sipas saj, sfida tjetër mbetet mbyllja e borxhit me "Z Mobile". "Problemet kyçe që rrezikojnë Telekomin për momenti janë mungesa e investimeve në infrastrukturë, kalimi në kodin 383 që është obligim dhe për momentin mungojnë mjete financiare në vlerë afërsisht pesë milionë euro, infrastruktura për përgjime që është një obligim ligjor që na kushton afërsisht tre milionë euro, licencat për

ARKEP-in që pritet të skadojnë vitin e ardhshëm, ato kapin vlerën mbi 20 milionë euro, mbyllja e borxhit me "Z Mobile" mbi 26 milionë euro dhe mbyllja e borxheve të akumuluar ndër vite", ka thënë Shatri-Berisha. Sipas saj, nëse nuk intervenohet shpejt, kjo ndërmarrje rrezikohet të falimentojë. "Përveç borxheve aktuale të njohura dhe gjendjes financiare, rreziku tjetër i madh vjen nga paditë në gjykata të cilat mund të rezultojnë në kosto të papërbalueshme për Telekomin", ka theksuar ajo.

Sipas Shatri-Berisha, daljen nga kriza ata e shohin përmes kredive nga aksionari, kredive nga bankat apo edhe tërheqjen e investitorëve të huaj. "Nëse nuk do të ndërmerren hapa, Telekomi do të vazhdojë të funksionojë edhe 12 muaj, pas kësaj kohe korporata nuk do t'ju takojë më juve si aksionarë, por do t'u takojë borxhlinjve", ka shtuar ajo, duke i drejtuar Qeverisë së Kosovës. Kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria nuk mundet dhe nuk ka logjikë t'i paguajë borxhet e Telekomit.

## Nga java e ardhshme fillon dezinfektimi i zonave endemike

**MALISHEVË, 23 PRILL (ER)** - Nga java e ardhshme planifikohet të fillojë dezinfektimi i zonave endemike kundër rriqrave në Komunën e Malishevës. Kështu është bërë me dije në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, e cila është drejtuar nga nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha. "Pasi janë kryer të gjitha përgatitjet dhe

kanë filluar të ngritën temperaturat, rriqrat kanë filluar të jenë më aktive. Në këtë drejtim nga java e ardhshme parashihet të fillojë fushata e dezinfektimit", ka thënë Berisha.

Në këtë mbledhje drejtorët e drejtorive kanë raportuar edhe për punët dhe aktivitetet e tyre në kuadër të realizimit të projekteve të planifikuara.



## Në Obiliq nis aksioni për eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave

**OBILIQ, 23 PRILL (ER)** - Nën kryetari i Komunës së Obiliqit, Ajet Berisha, përfaqësues nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Mjedis, përfaqësues të KEK-ut dhe të Kompanisë Regionale të Mbeturinave, të përkrahur edhe nga Stacioni Policor në Obiliq, FSK-ja, nxënësit e

shkollave të mesme dhe fillore, si dhe OJQ-të, kanë ndërmarrë të hënën aksionin e radhës për eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave. Po ashtu, ata filluan mbjelljen e luleve dhe të gjelbërimit me moton "Të gjithë së bashku për një ambient më të mirë".



## Rregullohet një pjesë e rrugës 'Fehmi Lladrovci' në kryeqytet

**PRISHTINË, 23 PRILL (ER)** - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka përfunduar rregullimi i një pjese të rrugës "Fehmi Lladrovci" në kryeqytet. Me këtë rast, kjo komunë ka falënderuar qytetarët për mirëkuptimin e treguar gjatë punimeve.

"Në afat rekord për pesë ditë pune ka përfunduar rregullimi i njërit kah të rrugës 'Fehmi Lladrovci', pjesa nga Rrethi i Flamurit deri tek rrethi i spitalit. Tani rruga është e gatshme për qarkullim. Tani do të nisim punimet në kahun tjetër.

Falënderojmë qytetarët për mirëkuptimin e treguar që po i shfrytëzojnë edhe rrugët alternative, duke iu shmangur kolonave të mundshme në atë pjesë të kryeqytetit", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



## Muharremaj: Theranda vazhdon të mbetet bastion i AAK-së

**THERANDË, 23 PRILL** - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) tash disa javë ka shpallur procesin e zgjedhjeve të brendshme nga do të dalin strukturat

e reja udhëheqëse të partisë. Procesi zgjedhor ka filluar edhe në Komunën e Therandës, ku deri më tani janë zhvilluar 14 kuvende zgjedhore. Sipas një komunikate për medie të kësaj partie, thuhet se interesimi i madh i qytetarëve për të marrë pjesë në këto kuvende, por edhe për t'iu bashkangjitur AAK-së, ka bërë që kjo degë të mobilizohet në organizimin sa më të mirë dhe gjithëpërfshirës të kuvendit të degës. "Një interesim i veçantë për t'iu bashkangjitur këtij procesi po vërehet sidomos te kuadrot e reja dhe bizneset e kësaj

komune. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës fton të gjithë qytetarët e Therandës të bashkëngjiten në procesin zgjedhor që po vazhdon. Ne jemi të hapur dhe mirëpresim kuadrot e reja që po ofrohen çdo ditë tek ne. Aleanca është e vetmja forcë politike në Therandë që në vazhdimësi ka krijuar hapësirë të mjaftueshme për ta zhvilluar aktivitetin e tyre politik", ka thënë kryetari i Degës së AAK-së në Therandë, Bali Muharremaj, duke shtuar se Theranda vazhdon të mbetet bastion i AAK-së.

## Nis manifestimi 'Java e dyerve të hapura'

**DRENAS, 23 PRILL** - Drejtoria Komonale e Arsimit në Drenas, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ka organizuar manifestimin "Java e dyerve të hapura", e cila u dedikohet semimaturatëve. Ky aktivitet do të zgjasë deri

më 27 prill. Për një javë rresht nxënësit e klasave të nënta në mënyrë të organizuar nga shkolla do ta vizitojnë Gjimnazin "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu" dhe Shkollën e Mesme Profesionale "Fehmi Lladrovci", ku do të marrin

informata të hollësishme për profilet që ofrojnë këto shkolla. "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu" dhe shkolla "Fehmi Lladrovci" kanë përgatitur fletëpalosjen dhe pankartën për orientimin dhe informimin profesional të nxënësve.

# Oazë e kujt është Kosova? (2)

A do ta forcojmë identitetin tonë evropian apo do të rrëshqasim stepave afrikane-aziatike?



Sylejman KRASNIQI

Dy-tri ditë para ngjarjes me shtetasit turq u mbajt gjykimi i imamit të xhamisë së Madhe të Prishtinës, Shefqet Krasniqi, i cili akuzohej për organizim të shkuarjes në Siri për pjesëmarrje në luftë në krah të ISIS-it të qytetarëve nga Kosova dhe për nxitje të terrorizmit. Ai u lirua nga gjykata i pafajshëm.

Këto ditë u mbajt seanca gjyqësore ndaj grupit të ashtuquajtur "Syri i popullit" të cilët akuzohen kinse për terrorizëm. Gjykimi u shty për një ditë tjetër.

Qeveritarët tanë (edhe gjyqësia e Kosovës) me endje e përdorin termin terrorist për pjesëtarët e kombit shqiptar, sidomos për rivalët politikë, që nuk ndodh askund në botë. Këta më së paku kanë të bëjnë me terrorizmin. Këtu kam parasysh dr.

prof. Sadri Ramabajën, një nga të akuzuarit e këtij grupi, i cili nuk ka të bëjë asgjë me terrorizmin, përpos nëse mund të quhet i tillë vetëm pse tërë jetën ka vepruar dhe punuar për çlirim të vendit të vet dhe për formimin e një shteti të mirëfilltë shqiptar. Mëkati i tij mund të jetë, ndoshta, pse ka qenë pjesëtar i LPK-së, e dihet tanimë se LPK-ja e ka qenë ideatorja dhe themeluesja e UÇK-së. Kjo, si duket, nuk u shkon përshtati pushtetarëve tanë. Prandaj edhe dëshirojnë të humbet çdo gjurmë e LPK-së dhe kështu historia të merret se fillon vetëm prej tyre.

Nëse analizohen me sy kritikë këto ngjarje të dy javëve të fundit, me të drejtë qytetari i Kosovës pyet se nga po e çon politika të ardhmen tonë? A e kemi të trasuar rrugën tonë të drejtë apo ajo është ende në kërkim e sipër? Nëse edhe sot hamendemi se nga do t'ia mbajmë, medet për ne se kush po na prinë. A nuk morëm përvojë të mjaftueshme nga sundimi pesëqindvjeçarë anadollak dhe gati njëqind vjet nën thundrën sllave? A nuk e morëm seriozisht porosinë e Frashërlive se "...dielli për shqiptarët lind atje

nga perëndon". A nuk morëm mësim nga gabimi i Sali Berishës kur na anëtarësoi në Konferencën Islamike? A do të sillemi evropiançe apo do të kthehemi me nostalgji tek turko-arabët apo tek stepat aziatike?! A jemi të vetëdijshëm se sa i ngushtë është bashkëpunimi islamo-ortodoks kundër qenies shqiptare?

Këto veprime e vënë në pikëpyetje edhe orientimin politik të Kosovës në vlimet aktuale gjeopolitike dhe gjeostrategjike dhe mund të ketë pasoja të papërmirësueshme në marrëdhëniet me miqtë tanë. Këtu i kam parasysh ndërhyrjen në zgjedhje të Rusisë në ShBA dhe në disa shtete të fuqishme të Evropës si dhe ndërhyrjet në vitet e fundit për t'i destabilizuar Maqedoninë dhe Malin e zi. Tani po shihet qartazi se radha është për t'i çregulluar trojet shqiptare para se të futet në BE i tërë Ballkani. Ndikimi rus në këto anë ka gjasë të depërtojë sepse, si duket, edhe ka investuar mjaft tash dhe në të kaluarën. Tani po ndihet një afri e madhe mes Rusisë dhe Turqisë ose mes ortodoksizmit dhe islamizmit. Që të dyja këto rryma e kanë

shtrirë ndikimin ekonomik dhe fetar në masë të madhe në këto anë. E ne, shqiptarët, kemi përvojë mjaft të hidhur nga Perandoria Turke dhe ajo sllave, prandaj duhet t'i hapim sytë mirë që të mos biem edhe një herë nën ndikimin e tyre, por të veprojmë dhe të sillemi si evropianë që jemi. Historia jonë shumë e bujshme nuk na lejon të harrojmë se sa të afërt janë islamizmi me ortodoksizmi. Nuk duhet ta harrojmë se nuk është rastësisht qendra, apo selia, ortodoksizmit në Stamboll e jo në Kremlin. Dhe kjo nuk është nga sot, por nga Epoka e Gjergj Kastriotit. Pra, që nga viti i largët 1458 kur nënshkruhet marrëveshja mes Sulltan Mehmetit të dytë dhe Patriarkanës së Stambollit (atëherë Kostandinopojës) e njohur si marrëveshja e miqësisë dhe bashkëpunimit mes fesë ortodokse dhe islame. Kjo marrëveshje asnjëherë në histori nuk është kontestuar e as rrezikuar për t'u anuluar ose rishikuar, por gjatë shekujve vetëm sa është kultivuar dhe begatuar, duke e trashë miqësinë e fesë islame dhe ortodokse. Nga ky moment sulltan Mehmeti i çon fjalë Gjergj

Kastriotit dhe i thotë se "Kostandinopoja ra", por Gjergji ynë ia kthen "Kruja jo". Dhe të gjitha të zezat për shqiptarët kanë ndodhur nga kjo marrëveshje. Këto të zeza po na përcjellin edhe në ditët e sotme. Shqiptarët kanë bërë shumë luftëra gjatë historisë. Shumë herë luftërat i kemi fituar, por pas luftës nuk kemi ditë të gjen-demi dhe fitoret kanë ngelur të gjymta, ndonjëherë edhe jemi kthyer mbrapa. Epoka e Gjergj Kastriotit ka qenë fitore e plotë. Në Luftën e Dytë Botërore u orientuam drejt dhe fituam si kurrë më parë. Edhe lufta e UÇK-së doli e suksesshme dhe u bëmë me shumë miq, si asnjëherë deri tani. Pas ngjarjeve të fundit, të cekura më lart, po vihet në pikëpyetje gjendshmëria e elitës sonë politike. A do të shkojmë drejt forcimit të identitetit tonë evropian apo do të rrëshqasim stepave afrikano-aziatike?

Kam frikën se me këto sjellje të elitës sonë politike prapë do të rishfaqet tek ne Vija e Teodosit, por tani nuk dihet se nga do t'ia mbajnë shqiptarët?! Do të shkojnë rrugës së trasuar nga rilindësit tanë apo do të zhyten në batakun e orientit e për t'u mos u ngritur më kurrë?! (Fund)



## Slovenia premtan përkrahje për Lipjanin në fushën e zhvillimit ekonomik

LIPJAN, 23 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Republikës së Sllovenisë në Kosovë, Bojan Bertoncej, me të cilin ka bashkëbiseduar për mundësitë e bashkëpunimit të Komunës së Lipjanit dhe Ambasadës së Sllovenisë në fushën e zhvillimit ekonomik.

Në takim ambasadori Slloven ka premtuar angazhim për promovimin e ambientit të të bërit biznes në Komunën e Lipjanit dhe tërheqjen e investitorëve të huaj. "Gjatë këtij takimi u diskutua për mundësitë e përfitimit të granteve nga Bashkësia Evropiane përmes mbështetjes së Qeverisë së Sllovenisë në fushën e menaxhimit të ujërave

të zeza përmes ndërtimit të impianteve", ka thënë Ahmeti. Po në këtë takim u diskutua rreth projekteve dhe mundësive të përkrahjes financiare të projekteve të mençura (SMART). Ndër projektet e diskutuara nga ky lëmë janë menaxhimi i mençur i parkingjeve, ndriçimi publik dhe menaxhimi i trafikut.

## Fillon renovimi i shkollës 'Dr. Ibrahim Rugova' në Obiliq

OBILIQ, 23 PRILL (ER) - Të hënën kanë nisur punimet për renovimin e sallës së edukatës fizike në Shkollën e Mesme të Ulët "Dr. Ibrahim Rugova" në Obiliq.

Kontrata për renovim është nënshkruar nga drejtorja e shkollës dhe kryetari i organizatës "Associazione Trentina" në Aiuto per i Balcani".

Ky projekt financohet nga Regione Autonome Trentina Alto Adige në bashkëpunim me organizatën e sipërpërmendur. Organizata "Associazione Trentina" për Ballkan me vite ndihmon arsimin dhe shëndetësinë në shtetet e Ballkanit. Kjo organizatë ka përfunduar disa projekte në shumë komuna të Kosovës.



## Macroni pritet ta mbrojë marrëveshjen bërthamore gjatë vizitës në ShBA

PARIS, 23 PRILL - Mospajtimet për marrëveshjen bërthamore të Iranit, e arritur me fuqitë botërore, priten të jenë temë kryesore gjatë vizitës së presidentit francez Emmanuel Macron në Shtetet e Bashkuara këtë javë.

Macron ka arritur të hënën në Uashington për një vizitë treditore, teksa presidenti amerikan, Donald Trump, ka vendosur 12 majin si afat të fundit që marrëveshja me Iranin të përmirësohet, në të

kundërtën ka kërcënuar se ShBA-ja do të tërhiqet nga ajo. Fuqitë e tjera që e kanë nënshkruar marrëveshjen e vitit 2015 - Britania, Kina, Franca, Gjermania dhe Rusia - i kanë bërë thirrje Uashingtonit të qëndrojë në këtë pakt, duke thënë se kjo është mënyra më e mirë për ta parandaluar Iranin që të zhvillojë armë bërthamore. Në një intervistë për "Fox News", Macroni kishte thënë se nuk ka "plan B" për këtë marrëveshje. Trumpi u ka bërë

thirrje fuqive evropiane t'i përmirësojnë, ato që ai i quan "të meta të tmerrshme" të marrëveshjes. Ai ka thënë se Irani po shkel shpirtin e marrëveshjes bërthamore.

Para vizitës së Macronit në ShBA, ministri i Jashtëm iranian, Mohammad Javad Zarif, u ka bërë thirrje liderëve evropianë ta "inkurajojnë presidentin Trump jo vetëm të qëndrojë në marrëveshje, por më e rëndësishmja ta nisë zbatimin e saj".



## Në prag të takimit mes dy Koreve

Veprimet pozitive kohët e fundit të Phenianit, përfshirë vendimin e njëanshëm për pezullimin e të gjitha provave bërthamore dhe me raketa, kanë krijuar një ton optimizmi se mund të arrihet një marrëveshje

SEUL, 23 PRILL - Takimi mes udhëheqësit të Koresë së Veriut Kim Jong Un dhe presidentit të Koresë së Jugut, Moon Jae-in, që do të mbahet të premten, më 27 prill, pritet të prodhojë një kornizë të bisedimeve mbi çarmatimin bërthamor, që presidenti amerikan Donald Trump mund ta mbështesë kur të takohet me udhëheqësin koreanoverior në maj, ose në qershor. Veprimet pozitive kohët e fundit të Phenianit, përfshirë vendimin e njëanshëm për pezullimin e të gjitha provave bërthamore dhe me raketa, kanë krijuar një ton optimizmi se mund të arrihet një marrëveshje. Por, ende nuk është e qartë nëse mund të arrihet një përparim i vërtetë drejt paqes.

Në të kaluarën janë zhvilluar dy takime ndër-koreane, njëri në vitin 2000, tjetri më 2007. Dy takimet janë mbajtur në Korenë e Veriut. I pari prodhoi një deklaratë të përbashkët për promovimin e shkëmbimeve humanitare dhe bashkëpunimin ekonomik.

Në takimin e dytë erdhi mbështetja për një traktat të përhershëm paqeje dhe për një marrëveshje të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara dhe Kina për t'i dhënë fund programit të armëve bërthamore të Phenianit, në shkëmbim të ndihmës ekonomike dhe garancisë për siguri. Megjithatë, provat e vazhdueshme bërthamore dhe me raketa të Koresë së Veriut i

dhanë fund çdo përparimi të bërë në këto takime.

Para takimit ndërkorean të nivelit të lartë këtë javë, ka pasur zhvillime inkurajuese për mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje bërthamore.

Sanksionet ndërkombëtare nën udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara po krijojnë vështirësi ekonomike në rritje, që mund ta shtojnë presionin ndaj udhëheqjes koreanoveriore për të hequr dorë nga arsenali i saj bërthamor. "Nëse situata e rëndë ekonomike vazhdon, shkëmbimi i valutave të huaja

do të pakësohet dhe Koreja e Veriut mund të përballet me një situatë shumë serioze në fund të këtij viti", thotë analisti Cheong Seong-Chang i Institutit Sejong. Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, ka bërë tashmë një numër lëshimesh duke rënë dakord të flasë për çarmatimin bërthamor pa kushte, duke pranuar të heqë dorë nga kërkesat e kaluara që Shtetet e Bashkuara t'i japin fund pranisë ushtarake në Gadishullin Korean dhe, së fundi, duke njoftuar pezullimin e provave bërthamore dhe me raketa, si dhe mbylljen e qendrave ku zhvillohen prova me armë bërthamore në vend.

Sidoqoftë, mbetet e paqartë nëse këtë herë Koreja e Veriut do t'i mbajë premtimet për çarmatim bërthamor. "Ne nuk jemi të sig-

urt nëse Koreja e Veriut do të heqë dorë nga armët bërthamore, apo nëse Pheniani po shfrytëzon angazhimin me Shtetet e Bashkuara për të dalë përkohësisht nga izolimi", tha ai. Presidenti i Koresë së Jugut, Mun-Jae-in, ka thënë gjatë bisedimeve paraprake, se Koreja e Veriut ka shprehur gatishmërinë për ta shqyrtuar çarmatimin e plotë bërthamor. Udhëheqësi progresiv ka mbështetur masat e ashpra të Shteteve të Bashkuara, përfshirë dislokimin e sistemit amerikan të mbrojtjes nga raketat, THAAD në Korenë e Jugut dhe sanksionet e ashpra të Shteteve të Bashkuara ndaj Koresë së Veriut.

Në të njëjtën kohë ai ka bërë përpjekje për përmirësimin e marrëdhënieve ndërkoreane,

duke lehtësuar pjesëmarrjen e Veriut në Lojërat Olimpikë Dimërore kohët e fundit.

Presidenti jugkorean Moon pret nga takimi arrijtjen e një marrëveshjeje për t'i rifilluar bashkimet familjare dhe për t'i rinisur përpjekjet për ta zëvendësuar me një traktat paqeje marrëveshjen e armëpushimit që i dha fund luftës, për të cilin duhet mbështetja e Shteteve të Bashkuara dhe Kinës.

Megjithatë, Moon nuk pritet ta mbështesë rritjen e bashkëpunimit ekonomik mes të dy vendeve, që do të përbënte shkelje të sanksioneve të OKB-së, dhe ai nuk do ta ngrejë në takimin me udhëheqësin e Phenianit, Kim Jong Un, çështjen e shkeljes së të drejtave të njeriut nga qeveria represive e udhëheqësit koreanoverior.



## Jep dorëheqje kryeministri i Armenisë

JEREVAN, 23 PRILL - Kryeministri i Armenisë, Serzh Sarkisian, ka dhënë dorëheqje, thuhet në një njoftim të publikuar në uebfaqen e tij. Dorëheqja e Sarkisianit vjen në kohën kur në Jerevan dhe në qytete të tjera, për të njëmbëdhjetën ditë me radhë, qytetarët kanë protestu-

ar duke kërkuar dorëheqjen e tij. Sarkisian u zgjodh kryeministër më 17 prill, vetëm tetë ditë pasi kishte përfunduar mandatin e dytë si president. Sipas ndryshimeve kushtetuese të miratuara më 2015 në Armeni, fuqitë kryesore ekzekutive kanë kaluar nga presi-

denti te posti i kryeministrit. Sarkisiani kishte deklaruar më parë se ai nuk ka për synim të bëhet kryeministër, por pas zgjedhjes së tij në këtë post, protestuesit e kanë akuzuar se ka shkelur këtë zotim vetëm për të qëndruar në pushtet.



# Institucionet të bëjnë më shumë për ta përkrahur librin

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë ka bërë që lexueshmëria e librit të bjerë dukshëm. Kështu është thënë të hënën në aktivitetin e mbajtur në Bibliotekën Kombëtare me rastin e Ditës Botërore të Librit. Udhëheqësja e Departamentit të Edukimit Bibliotekar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Ramize Bajraktari, ka thënë se interesimi për të lexuar ka rënë ndër vite. Sipas saj, mungesa e lexueshmërisë së librave dhe zëvendësimi i tyre me teknologjinë informative ka bërë që shumë nxënës të kenë probleme në mësimnxënie. "Shumë fëmijë po hasin në vështirësi në mësimnxënie, sepse prania e teknologjisë informative po zbeh gjithnjë e më tepër imazhin e leximit të librave. Në rrjete sociale janë të hapura shumë faqe leximi, ku mund të gjesh analiza dhe rekomandime të ndryshme, por asnjëherë nuk mund të zëvendë-



sohet libri fizik në këtë formë", ka thënë Bajraktari. Ndërsa Hatmane Demiri, drejtoreshë e shkollës "Ismail Qemali", ka folur për rëndësinë e madhe të librit, duke bërë apel që të rinjtë dhe të vegjlit t'i lënë telefonat e të lexojnë sa më shumë. "Ta vizitojmë sa më shumë bibliotekën dhe të lexojmë sa më shumë. T'i lëmë pak telefonat

anash. Të gjitha shkollat dhe të gjithë ne duhet të bëjmë thirrje që sa më shumë të lexojmë, sepse nuk mund të ecim përpara pa lexim dhe pa dije", ka deklaruar Demiri. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se kjo ditë na kujton vlerën universale të librit si mjet i patejkalueshëm i shënimit të

## Kurteshi kërkon fond për librin

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, në Ditën Botërore të Librit ka thënë se mungesa e fondeve për librat është duke shkaktuar analfabetizëm në vendin tonë. "Shqetësimi i Lëvizjes Vetëvendosje është mungesa e fondeve për librin. Qeveria nuk ndan thujse fare pak për librin. Për librin ndahen vetëm fonde", ka thënë Kurteshi në një konferencë

për medie. Kurteshi ka thënë se mungesa e librave në Kosovë ka shkaktuar analfabetizëm tek rinia. Sipas tij, gjendja në Kosovë është alarmante. Ai ka kërkuar nga Qeveria dhe nga institucionet e tjera të krijojnë një fond për librin, për heqjen e TVSh-së për librat dhe për krijimin e një marrëveshje me Shqipërinë për përkthimin e librave.

dijes, shkencës, letërsisë, artit dhe komunikimit njerëzor. "Kjo ditë, përpos botimit, leximit dhe promovimit të librit, na fton për ta mbrojtur të drejtën e autorit, përkatësisht vlerësimin e integritetit të krijuesve të vlerave diturore dhe shpirtërore. Kosova

është pjesë e botës ku me ligj mbrohet e drejta e autorit. Institucionet tona kulturore dhe arsimore duhet të bëjnë edhe më shumë për ta përkrahur librin, botuesin dhe lexuesin", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

# Elena Halilaj përfaqëson Kosovën në Maltë

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - 14-vjeçarja Elena Halilaj, nxënëse e klasës së tretë në Shkollën e Muzikës "Amadeus", drejtimi Violinë dhe Solokëndim, do ta përfaqësojë shtetin e Kosovës në Festivalin Ndërkombëtar të Këndimit "Euro Stars", i cili do të mbahet në Maltë nga 25 deri më 30 prill të këtij viti. Halilaj do të marrë pjesë në mesin e 17 shteteve dhe 120 pjesëmarrësve në këtë festival të karakterit garues. Festivali "Euro Stars" është mundësi e mirë për këngëtarët e rinj si dhe një privilegj i rrallë për pjesëtarët e industrisë muzikore. Sipas njoftimit zyrtar, misioni i këtij festivali është përkrahja e talenteve të rinj premtues të



cilët dëshirojnë të trajnohen dhe të mësojnë. Elena Halilaj ka pranuar ftesë nga organizatori dhe drejtori i festivalit, Martin DeGabriele, i

cili e kishte parë atë duke përfaqësuar Kosovën vitin e kaluar në Ohër, në festivalin ndërkombëtar "Tra la la". Elena Halilaj ndjek mësimin



edhe në klasën e tetë në Shkollën Filllore "Don Bosko" në Prishtinë. Elena ka marrë pjesë në Prishtinë "Kids Fest 2016", ku ka zënë vendin e

tretë. Po ashtu, ajo ka përfaqësuar Republikën e Kosovës edhe në Festivalin Ndërkombëtar në Ohër "Tra la la" në vitin 2017.

# Në Ditën Botërore të Librit, Kolegji AAB themelon çmimin 'Masar Stavileci'

PRISHTINË, 23 PRILL (ER) - "Mua më shumë më pëlqen të lexoj sesa të shkruaj", kishte thënë profesor Masar Stavileci, tashmë i ndjerë, në nderim të të cilit Kolegji AAB, në Ditën Botërore të Librit, ka themeluar çmimin "Masar Stavileci" për studentët dhe lexuesit e rregullt të bibliotekës universitare të këtij kolegji. Rektori i Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, në një ngjarje të organizuar nga Biblioteka

Universitare dhe Kolegji AAB ka theksuar se profesor Masari ishte rektori i parë i Kolegjit AAB, ishte profesor, mik dhe koleg. "Ne kemi pasur fatin të jemi miq me të. Dhe, përveç faktit që ai ishte edhe autor dhe përkthyes i librit, ai gjithnjë thoshte se më shumë i pëlqente të lexonte", ka thënë Tafa. Në ndarjen e këtij çmimi ishin të pranishëm edhe familjarët e profesorit të ndjerë Masar Stavileci. Me këtë rast, i biri,

Blerand Stavileci, ka thënë se ndihet i emocionuar dhe shumë i nderuar si familje. "Në një ditë kaq të veçantë, siç është Dita Botërore e Librit, rektori dhe Kolegji AAB kanë vendosur të mbajnë dhe nderojnë emrin e prindit tonë. Babi e kishte librin mikun më të mirë. Ai jetonte për të, çdo gjë sillej rreth librit, për librin dhe me librin, andaj jemi shumë të nderuar pikërisht për këtë", ka deklaruar Blerand Stavileci.



**E jashtëzakonshme**

# Korridori mahnitës prej dëbore

Një nga malet më aventureske, Tateyama Kurobe Route Alpine në Japoni, është rihapur për turistët për një tjetër sezon. Rruga 90 kilometra e quajtur "Kulmi i Japonisë" ofron pamje të pabesueshme. Ky korridor i krijuar me mure dëbore ka lartësinë 17 metra dhe do të jetë i hapur deri më 22 qershor. Pritet që ky korridor të vizitohet nga 5 000 vizitorë në ditë gjatë muajit prill dhe maj.



**FOTO E DITES**



Mbahet maratona në qytetin e Vjenës në Austri /AFP/

**E rrallë**

# Gjobitet 500 dollarë për një mollë që linja ajrore ia ofroi falas në avion

Një grua përballet me gjobën prej 500 dollarësh nga Agjencia e Klientit në Amerikë, për një mollë që iu gjet në çantë, të cilën e kishte marrë nga linja ajrore gjatë udhëtimit. Crystal Tadlock, e cila udhëtonte nga Amerika për në Paris, ka treguar se



e ruajti mollën për ta ngrënë në udhëtimin tjetër që kishte për në Denver.

## BARSOLETA E DITËS



- Linda do të shkosh ndokund në pushim gjatë verës
- Po në Bora Bora nja dy javë, e ti ku?
- Unë në Shpija Shpija nja tre muaj kësmet



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

## "BLACK PANTHER"

3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.  
Regjia: Ryan Coogler




Në ora 17:00

## "PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.  
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

## "PACIFIC RIM UPRISING"

(PG-13) Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.  
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

## "RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.  
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), **fb: Kino ABC.**



**DASHI**  
Keni vënë piketat për çështjet me të rëndësishme që do të merrni sot. Ju kanë mbetur vetëm detajet për të përcaktuar.



**DEMI**  
Një pjesëtar i familjes tuaj do të ketë nevojë për praninë tuaj sot. Anashkaloni çdo gjë tjetër për t'iu gjendur pranë.



**BINJAKËT**  
Edhe ju mund të lodheni nga rutina e përditshme dhe doni të bëni diçka ndryshe. Kërkoni opsione që mund t'ju kënaqin.



**GAFORRJA**  
Sot nuk do të jetë zgjidhje e mirë të lini përgjysmë një projekt të nisur. Bashkëpunëtorët tuaj do të ecin shumë përpara jush.



**LUANI**  
Këtë periudhë keni qenë shumë të impenjuar të zgjidhni çështje urgjente profesionale dhe kjo ka ndikuar për keq në humorin tuaj.



**VIJRGJERESHA**  
Nuk ju mbetet shumë për t'u menduar sot, sepse çdo gjë që keni vendosur ka marrë drejtim. Ju mbetet veç të shijoni kohen.



**PESHORJA**  
Momentet tuaja me të mira sot do t'i kaloni në shoqërinë e miqve të mirë, por që i takoni rrallë për shkak të largësisë.



**AKREPI**  
Edhe pse nuk doni të shfaqeni sot do të jeni pjesë e rëndësishme në realizimin e një ëndrre te hershme te partnerit.



**SHIGJETARI**  
Jo gjithmonë keni qenë të aftë të fitoni besimin e personave afër jush. Për këtë arsye sot do të merrni disa kritika konstruktive.



**BRICJAPI**  
Edhe të tjerët kanë limitet e tyre kështu që jo gjithmonë duhet të jenë në favor të zgjedhjeve dhe humorit tuaj të momentit.



**UJORI**  
Po vini në zbatim disa ide të rëndësishme, por do të hasni në pengesa nga persona që nuk ua ka pritur mendja se mund t'ju pengonin.



**PESHQIT**  
Gjërat e vogla të jetës janë ato që ju mbajnë në humor dhe që ju japin energji për të përballuar çdo problem të ditës.


## Ed Sheeran për albumin e ri: Nuk më intereson nëse dështon



**E**d Sheeran ka zbuluar detaje të reja mbi albumin e ardhshëm. Ai ka thënë se nuk ka rëndësi nëse ky album i ri dështon. Albumi i fundit i 27-vjeçarit 'Divide' ishte një sukses i madh

mbarëbotëror. Në një intervistë me gazetën "Sunday Mirror", artisti ka pohuar se albumi i ri nuk do të jetë pop. "E di që njerëzit presin që albumi i ri të jetë edhe më i mirë", ka thënë Ed Sheeran.

## Rihanna lanson linjë të veshjeve të brendshme



**P**asi hyri në botën e kozmetikës, këngëtarja dhe ikona e stilit do ta lansojë linjën e rrobave të brendshme, Savage x Fenty. Këtë e ka

bërë me dije vetë ajo përmes një postimi në rrjetin social "Instagram", ku kishte bashkangjitur një video të shkurtër paralajmëruese.




## Britania, me një Princ të ri

**D**ukesha e Kembrixhit ka sjellë në jetë fëmijën e saj të tretë, një djalë, pikërisht në ditën e "St George". Lajmi është

bërë me dije nga Pallati mbretëror i Kensingtonit. Kate u dërgua në spital mëngjesin e së hënës në "St Mary" të Paddingtonit, në Londër.


## Poster i rrallë i Elvis Presleyt shitet në ankand për 42 000 dollarë

**N**jë poster i rrallë i mbretit të popit, Elvis Presley, është shitur në ankand për më shumë se dyfishin e çmimit të pritur. Poster i realizuar për një shfaqje të koncertit më 19 maj 1955 u shit në ankand për 42 000 dollarë. Giles Moon of Texas priste që poster i të



shitej për 20 000 dollarë. Poster i reklamon një koncert në Raleigh të Presleyt. Blerësi dhe shitësi e këtij poster i kanë preferuar të mbeten anonimë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

DERBY - CARDIFF

GG

OLDHAM - SOUTHEND

1

AUXERRE - REIMS

2


## Berisha: Fusha, pengesë e madhe për FC Dardanët

"Rezultatet në përgjithësi janë të mira, por mungesa e fushës ka ndikuar që mos t'i kemi rezultatet që donim. Megjithatë, synime për këtë edicion kemi të bëhet konsolidimi i skuadrës, kurse në edicionin e ardhshëm të kemi edhe më shumë suksese. Ajo që kisha veçuar është se kemi raporte të mira ndërmjet vete të gjithë lojtarët, kurse me kryesinë kemi raporte profesionale", ka thënë Xhemajl Berisha

**EPOKA E RE** **Liridon ZEQRIRI**

**GJAKOVË, 23 PRILL** - Kapiteni i skuadrës FC Dardanët nga Gjakova, Xhemajl Berisha, ka lindur në nëntor të vitit 1998 në Gjakovë. Ai në vitin 2010 filloi të merret me futboll në shkollën "Makeup", pastaj kaloi në KF Gjakova, me të cilën u shpallë tri herë radhazi kampion i qytetit si dhe ishte pjesëmarrës në disa turne në Shqipëri dhe Suedi.

Talenti i tij është vërejtur në këta turne dhe skuadra e madhe gjakovare e transferoi në radhët e veta. Në skuadrën kuqezi qëndroi dy vjet e më pas zgjodhi t'i bashkohet skuadrës së Dardanëve, e cila është riaktivizuar në vitin 2007. Berisha të hënën për "Epokën e re" ka thënë se rezultatet e skuadrës nga Gjakova në Ligën e Dytë janë të mira, por mungesa e stadiumit ka ndikuar shumë në rezultate. "Rezultatet në



përgjithësi janë të mira, por mungesa e fushës ka ndikuar që mos t'i kemi rezultatet që donim. Megjithatë, synime për këtë edicion kemi të bëhet konsolidimi i skuadrës, kurse në edicionin e ardhshëm të kemi

edhe më shumë suksese. Ajo që kisha veçuar është se kemi raporte të mira ndërmjet vete të gjithë lojtarët, kurse me kryesinë kemi raporte profesionale", ka thënë Berisha, i cili nuk e përjashton mundësinë e

rikthimit të skuadra e Vëllanzimit. "Vëllaznimi është klubi i qytetit tim dhe shpresoj se një ditë sërish të jam pjesë e tij", ka shtuar ai. Xhemajl Berisha më pas foli edhe për futbollin e Kosovës në përgjithësi, duke thënë se çdo vit po ka ngritje të cilësisë. "Futbolli i Kosovës ka shënuar një ngritje të konsiderueshme dhe vit pas viti po bëhet mirë e më mirë si për nga cilësia, po ashtu edhe nga kushtet në infrastrukturë", ka shtuar ai.

Berisha në fund shprehu falënderim për Ambroz Rrustemin dhe firmën e tij "AAR Niki-s", pasi po e ndihmon skuadrën gjakovare.

FC Dardanët pozicionohen në pozitën e dhjetë në Ligën e Dytë të Grupit A me 31 pikë të grumbulluara.

## Trajnerët dhe sportistët elitare mbështeten nga MKRS-ja

"Nënshkruam memorandume me katër trajnerë sportivë. Ne si ministri e vlerësojmë punën e secilit prej trajnerëve në fushën e vet, sepse secili ka dhënë kontribut të veçantë për sportin dhe sportistët tanë dhe, po ashtu, për vendin, duke realizuar suksese në sport dhe në gara ndërkombëtare", ka thënë ministri Gashi

**"Epoka e re"**

**PRISHTINË, 23 PRILL** - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) vazhdon të jetë përkrah sportistëve. Numri një i kësaj ministrie, Kujtim Gashi, të hënën ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me trajnerët e suksesshëm në arenën ndërkombëtare dhe sportistët elitare.

Trajneri i reprezentacionit të Xhudos, Driton Kuka, do të mbështetet me 15 mijë euro, kurse trajnerja e karatesë, Shqipe Zogiani, është mbështetur me 3 600 euro, trajneri Burim Vraniqaj mbështetet me 2 000, kurse Asdren Ahmeti me 1 800 euro. Ministri Gashi ka thënë se përmes kësaj mbështetjeje finan-



ciare për trajnerët e sportit po realizohen politikat programore të MKRS-së. "Nënshkruam memorandume me katër trajnerë sportivë. Ne si ministri e vlerësojmë punën e secilit prej

trajnerëve në fushën e vet, sepse secili ka dhënë kontribut të veçantë për sportin dhe sportistët tanë, po ashtu edhe për vendin, duke realizuar suksese në sport edhe në gara ndërkombëtare", ka thënë ministri Gashi.

Ndërsa Kuka, Zogiani, Vraniqaj dhe Ahmeti e kanë vlerësuar shumë të rëndësishme mbështetjen financiare nga Ministria e Sportit. Të hënën ministri Gashi ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi edhe me gjashtë sportistë elitare. Fjala është për Distria Krasniqin, e cila përfiton nga kjo marrëveshje 5 400 euro, kurse një prej sportistëve më të mëdha në vend, Nora Gjakova, mbështetet me 4 800 euro. Edhe vëllai i Norës, Akili, mbështetet me 4 500 euro. Me nga 1 200 euro mbështeten sportistët Laura Fazlia dhe Shpat Zeka, ndërkaq sportistja Lorian Kuka me 2 400 euro.

## Spanja humbet organizimin e evropianit shkak i Kosovës

**PRISHTINË, 23 PRILL** - Spanja ka humbur të drejtën e organizimit të Kampionatit Evropian U-23 të Peshëngritjes për shkak të moslejimit të pjesëmarrjes së peshëngritësve të Kosovës. Qeveria spanjolle nuk i është përgjigjur letrës së dërguar më 27 mars nga Federata Evropiane e Peshëngritjes (EWF) përmes së

cilës do ta garantonte pjesëmarrjen e Kosovës në këtë kampionat. Për këtë arsye, Spanja është njoftuar nga Federata Evropiane që ka humbur të drejtën e organizimit të këtij kampionati. Lajmi është konfirmuar edhe nga kryetari i Federatës së Peshëngritjes së Kosovës (FPK), Astrit Hasani, i

cili është njoftuar edhe nga EWF-ja. Spanja është një nga vendet e pakta evropiane që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe pasaportat e saj. Kampionati në fjalë ishte paraparë të mbahej prej 23-31 tetorit 2018, kurse tani pritet të zhvendoset në Poloni. Javën e kaluar, gjatë Konventës

së SportAccordit, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (KON) dhe Asociacioni i Federatave të Sporteve Olimpikë Verore kishin kërcënuar me dënime shtetet që diskriminojnë sportistët e Kosovës me moslejimin e pjesëmarrjes së tyre shkak i politikës dhe një gjë e tillë duket se dha efekt të dielën.



## Messi, futbollisti më i paguar në botë

**BARCELONË, 23 PRILL** - Lionel Messi është dominuesi në financa për sa i përket futbollit. Sipas revistës prestigjioze franceze "France Football", sulmuesi argjentinas i Barcelonës është lojtari më i paguar në botë për sezonin 2017-2018. "France Football", e cila ka përcaktuar listën e futbollistëve që kanë përfituar më shumë të ar-

hura financiare, e ka bazuar studimin e saj te paga bruto e futbollistëve, shpërblimet dhe të ardhurat nga kontratat me kompanitë publicitare, të përfituara gjatë këtij sezoni.

Nga përlogaritjet rezultojnë se Messi e ka tejkaluar shifrën e 100 milionë eurove, më saktësisht ai përfiton 126 milionë euro.

Argjentinasi e zbriti në vendin e dytë Cristiano Ronaldo, kryesuesin e vitit të kaluar. Ylli i Realit të Madridit ka siguruar 94 milionë euro për këtë sezon. Podiumin e plotëson braziliani Neymar, që ka përfituar 81.5 milionë euro këtë sezon. Klasifikimi vijon me një tjetër futbollist të Realit të Madridit, Gareth Bale, i pozi-

cionuar në vendin e katërt me 44 milionë euro, duke lënë pas qendërmbrojtësin e Barcelonës, Gerard Pique, me 29 milionë euro. Për sa iu përket trajnerëve, sipas "France Football", më i paguari për këtë sezon është tekniku i Manchester Unitedit, Jose Mourinho, me 26 milionë euro, i ndjekur nga Marcelo Lippi i për-



faqësueses kineze, me 23 milionë në vendin e dytë, si dhe Diego Pablo Simeone i Atletico Madridit, me 22 milionë euro.

## Përballja e befasive

**LIVERPOOL, 23 PRILL** - Sonte (e martë) zhvillohet ndeshja e parë gjysmëfinale në Ligën e Kampionëve në mes të Liverpoolit dhe Romës. Kjo ndeshje cilësohet edhe si përballja e befasive për faktin se këto dy skuadra shkaktuan befasi të mëdha në këtë edicion duke u kualifikuar deri në këtë raund, ani pse në fillim nuk ishin në mesin e favoriteve që mund të triumfojnë në këtë garë. Dy skuadrat e fuqishme, Barcelona dhe Manchester City, janë eliminuar nga këto dy skuadra.

Trajneri i Romës, Eusebio Di Francesco, e ka vlerësuar Liverpoolin para përballjes në "Anfield Road". "Në këtë sezon jemi rritur shumë, por tekta Liverpooli e ka siguruar praninë në Ligën e Kampionëve për sezonin e ardhshëm, duke qenë në vendin e tretë të Premier Ligës, ne që jemi të tretët në Serinë A ende nuk ia kemi dalë, por kemi shumë besim", ka thënë Di Francesco, i cili më pas foli edhe për ish-lojtarin e Romës, Mohamed Salah. "Djemtë më kanë thënë se është një njeri i madh, një profesionist i vërtetë që punon shumë. Faktikisht, kjo duket qartë. Gjithsesi, favori ynë është që e njo-



### Formacionet e mundshme:

**LIVERPOOL (4-3-3):** Karius; Alexander-Arnold, Lovren, Van Dijk, Robertson; Milner, Oxlade-Chamberlain, Wijnaldum; Salah, Firmino, Mane.  
**AS ROMA (3-5-2):** Alisson; Fazio, Manolas, Juan Jesus; Florenzi, Strootman, De Rossi, Nainggolan, Kolarov; Schick, Dzeko.

him mirë si luan Salah, ndërsa në Angli kanë filluar ta njohin vetëm pasi shënoi 30 gola", ka shtuar ai. Fjalë të mira për skuadrën e Romës ka folur trajneri i skuadrës së Liverpoolit, Jurgen Klopp. "Nuk është short i lehtë. Njësoj do të ishte edhe me Bayernin dhe Realin. Të gjitha ekipet në këtë fazë janë të forta. Dua t'ju kujtoj

ndeshjen që Roma zhvilloi me Barcelonën. Në ndeshjen e dytë ishte e jashtëzakonshme çfarë bënë ata dhe është dashur të fitojnë 4-0 ose 5-0. Nuk kam qenë kurrë në Romë, por di që ata kanë një skuadër shumë cilësore. Ne do të tentojmë të marrim rezultate pozitive në të dyja ndeshjet", ka deklaruar Kloppin.

## Clevelandi barazon serinë me Indianën

**OHIO, 23 PRILL** - Edhe pse ka vuajtur shumë, skuadra e Clevelandit mposhti 104-100 Indianan në çerekfinalen e katërt mes dy ekipeve në Konferencën e Lindjes, duke barazuar 2-2 serinë e ndeshjeve. Indiana dominoi në ndeshje në shumicën e kohës, u shkëput deri në 17 pikë falë një loje të mirë kolektive (7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë), por në fund erdhi përmbyjsja e miqve.

LeBron Jamesi realizoi 32 pikë e 13 rebaunde, duke qenë lider në parket për Cavaliersin, që tashmë rikthehet të luajë në fushën e vet. Barazim 2-2 me ndeshje edhe në përballjet e tjera në Konferencën e Lindjes, ku Milwaukee mposhti 104-102 Bostonin, në një ndeshje të dominuar nga vendësit që e merituan fitoren.

Antetokoumpo me 27 pikë e Middletoni me 23 ishin më të mirët në fushë për Milwaukeeen, ndërsa 34 pikët e Brownit për



### KONFERENCA E LINDJES

1-8 Toronto - Washington	98-106 (barazim 2-2 me ndeshje)
2-7 Boston - Milwaukee	102-104 (barazim 2-2 me ndeshje)
3-6 Philadelphia - Miami	(3-1 me ndeshje)
4-5 Cleveland - Indiana	104-100 (barazim 2-2 me ndeshje)

### KONFERENCA E PERËNDIMIT

1-8 Houston - Minnesota	(2-1 me ndeshje)
2-7 Golden State - San Antonio	90-103 (3-1 me ndeshje)
3-6 Portland - New Orleans	(0-4 me ndeshje)
4-5 Oklahoma - Utah Jazz	(1-2 me ndeshje)

Celticsin mbetën për statistikë. Në takimin tjetër Washingtoni mundi 106-98 Toronton, duke barazuar 2-2 serinë e çerekfinalëve, sfida ku për vendësit u dal-

luan Beali me 31 pike e Walli me 27. Fitoren e parë në fazën çerekfinale e korri sot skuadra e San Antonios, që mundi 103-90 Golden Staten, me Warriorsin që tashmë udhëheq 3-1 serinë e takimeve. Spursi dominoi në ndeshje dhe fitoi me meritë, takim ku u dallua Aldridge me 22 pikë e 10 rebaunde, ndërsa 34 pikët e 13 rebaundet e Durantit për ekipin kampion të NBA-së mbetën për statistikë.

### SHKURT

#### Rivaldo, Neymarit: Shko në Real

"I kam thënë se mund të bëhej futbollisti më i mirë në botë por, besoj, po qëndroi te Paris Saint-Germain, nuk do t'ia dalë". Këto janë fjalët e një ikone të futbollit brazilian, siç është Rivaldo, në një intervistë me "Globoesporte". Ish-mesfushori i ekipeve të mëdha Barcelona e Milan ka një këshillë për "yllin" aktual të "Selecaos". "Duhet të largohet nga PSG-ja. Në futboll, për të qenë më i miri, duhet të luash në Spanjë. Te Barcelona, duke parë situatën, ishte e vështirë, sepse Messi është ende i pari, por nëse ka vërtet mundësi të shkojë te Real, nuk duhet të mendohet gjatë. Atje mund të bëhet lojtari më i mirë në botë". Në këtë deklaratë të tij Rivaldo i referohet edhe moshës së Cristiano Ronaldos, që nuk do të mund ta ruajë për një kohë të gjatë të njëjtin nivel.

#### Allegri: Me Interin, ndeshja e sezonit

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, pas humbjes nga Napoli (0-1), ka thënë se "Zonja e Vjetër" është dashur të marrë një pikë në ndeshjen ndaj rivalëve të drejtpërdrejtë në luftën për titull. "Ishte një ndeshje e shëmtuar për të dyja skuadrat, me pothuajse asnjë gjuajtje në portë. Ne kishim vështirësi, por mund ta çonim në barazim ndeshjen në fund", ka thënë Allegri, duke shtuar: "Për fat të keq pësua gol në fund, në një aksion ku nuk markuam. Ishte ndeshje e drejtpërdrejtë dhe Napoli bëri atë që duhej, mbajti më shumë topin dhe për këtë duhet të komplimentohet sepse meritoi. Tani na pret ndeshja më përcaktuese e sezonit, ajo kundër Interit në Milano. Duhet sa më parë të harrojmë këtë humbje dhe t'i rikthehemi punës. Ky është futbollit: ata janë më të fortë nën presion. Disa vështirësi ne i shfaqëm që në ndeshjen me Crotonen, por tani ajo ndeshje iku".

#### Pogba mohon problemet me Mourinon

Paul Pogba mohon problemet me trajnerin Jose Mourinho, ani pse në këtë sezon është ulur edhe në bankën rezervë. "Nuk kam asnjë problem me të. Jam pjesë e një klubi të madh, Manchester Unitedit. Jam futbollist me ambicie dhe më pëlqen të jap më të mirën. Ai është trajner, ai i merr vendimet. Si lojtar i pranoj ato", ka thënë Pogba, i cili ka hedhur poshtë mundësinë e largimit nga "Old Trafford". "Nuk mendoj kështu. Nëse luan dikush tjetër në vendin tim, kjo nuk është padrejtësi. Ndodh vetëm për shkak se trajneri po kërkon diçka tjetër. Ne lojtarët duhet ta pranojmë këtë. Ndoshta ishte rasti për Romelu Lukaku, ose Marouane Fellaini", ka deklaruar Pogba.

#### Henderson: Salah, në nivel me Messin dhe Ronaldo

Në bazë të paraqitjeve dhe ndikimit që ka pasur këtë edicion në shumë ndeshje, duke e ndihmuar Liverpoolin, Jordan Henderson beson se Mohamed Salah është pothuajse në një nivel me Lionel Messin dhe Cristiano Ronaldo. Egjiptiani deri më tani ka shënuar 41 gola në të gjitha garat, 31 në Premierligë. Ai është rrugës së mirë për ta fituar "Këpucën e Artë" në Premierligë, ndërsa po konkurren edhe për atë të Evropës me Lionel Messin e Ciro Immobilen - këta dy të fundit kanë shënuar nga 29. "Salah si Messi e Ronaldo? Messi dhe Ronaldo kanë qëndruar në nivele të larta për më shumë se 10 vjet, por Salah është mjaftueshëm i mirë që të qëndrojë gjatë në këtë nivel dhe të përmirësohet", u shpreh Henderson. "Definitivisht, këtë sezon, duke parë mënyrën se si ka luajtur, golat që ka shënuar dhe ndikimin që ka pasur në shumë ndeshje, nënkupton se ai është atje lart dhe mund të krahasohet me më të mirët", ka shtuar Hendersoni.

<b>Autor:</b> <b>BENI</b>	GATESE E JONA TRADICIONALE (shq.)	TERRITOR KU SUNON EMIRI	KËNGËTARE SHQIPTARE NË FOTO 1	SHTET I MADH NË AZI	FLOTA DETARE	ENI LENOX	LLOJ, SOJ	<b>EPOKA E RE</b>	DHËNIA E BESËS	EMNAK I EMRIT ATENA	ROMA	AKTORJA ANGLEZE FRIEL	SHTET NË AZI ..... LINDOR ZAIRI, ANGOLA	MODEL I SAKTË E I ZVOGLUAR I NJË OBJEKTI	THIRRJE E MYEZINIT	PËREMËR VETOR		
ZARZAVATET								PËRFUNDIMET PA FITUES REKUZITË SPORTIVE										
PANDERSHMËRI											FALJE FETARE MYSLIMANE QË BËHET PESË HERË NË DITË (shq.) RFIAT KUKAJ							
QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI						ZHURMA E MADHE MË ZË GJUMI DUKE NDEJUR, DREMIT							NJËSI E VJETËR E PESHËS INDIUM			ANNA VISSI		
LUMI I GJAKOVËS (pashq.)							KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE					AKTORJA ARVANITASE PAPAS LETRARI YNË ASLLANI						
ARTAN (perkdh.)				VLERËSIM I NXËNSIT NGA MËSUESI FUTBOLLIST BRAZILIAN (MILAN)						AKTORI YNË QOSJA (shq.)	AKUZUES I SOKRATIT FLUTURUES I PARË MITIK				VLORA			
<b>EPOKA E RE</b>	FUQIA, FORCA (krah.)							JETË E QETË DHE PA TRAZIME TRAJNERI YNË VOKRRI										
DYRRAHU		DANTE ALIGIEIRI RELIANCE INDUSTRIES LIMITED			PJATA				OPEN KNOWLEDGE INITIATIVE NDRËHYRJE KIRURJIKE									
KITARISTI KLEPTON					KËNGËTARE E SHQUAR AMERIKANE NATRIUM											KËNGËTARJA PERUANE SUMAK		
KLUB FUTBOLLI ITALIAN						VETIA, CILËSIA DEPUTET YNI												
INTERNATION. LABOUR ORGANIZATIO.				JETËSHKRIM-ET							MALTA KRYEVEPRA E LEONARDO DA VINÇIT							
								VARGJE TË PËRPTHURA DAUGHTERS REPUBLIC TEXAS										
				SHTET I MADH NË AZI (pashq.)						OHAJO SHKOVË, ECE		ZBRITJET E AVIONËVE NË TOKË	BASKETBOLL-ISTI YNË BESIM		PJESË E FORTË E BUKËS "I" NË MES TË DY "R"	KËNGËTARJA SHQIPTARE NË FOTO 2 GJONI	<b>EPOKA E RE</b>	
				FILM I NJOHUR I ARNOLD SHWARCENE-GER													VEPËR E KRYER (shq.)	
				HERVATSKA RADIO TELEVISION					AKTORJA E VJETËR SHQIPTARE JOSIPI HISTORIANI ROMAK LUKRECI									
				ZANORE		GAZETARI I VOA BIBERAJ (shq.)		MJET PËR BARTJE NË VISE MALORE MUAJI I DHJETË I VITIT										
				PJESË E LOJËS NË TENIS (shq.)						JO I VJETËR				ELIZABET TEJLOR	STEFANO TONTE KËNGËTARJA MË FAMË BOTËRORE TIKARAM			
<b>EPOKA E RE</b>	PRIJËS I HUNËVE	TRAJNERI TURK FATIH	THIRRJE TELEFONIKE	MENSURI (perkdh.)	MJET PUNE AFROVA (krah.)					SIRENAT, ALARMET NGJITËS I XHAMAVE						ZANORE KALORËS MESJETAR		
PJESTARET E ATAMANËVE									FAJDEXHI PAJTIM (vjet.)								AKTORJA AMERIKANE ..... FLYNN	
APARAT I POSAÇËM ME EKTRAN (shq.)											ESTONIA, JEMENI KËNGËTARJA JONË ZARI			LUMË I MADH NË AFRIKË "DETROIT"				
